



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë më, 05.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Mbledhje e komisionit në lidhje me kërkesën e Asamblesë së Pedagogëve për t'u dëgjuar nga Komisioni.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Vilma Bello, Musa Ulqini, Adelina Rista, Agron Çela, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Almira Xhembulla, Mirela Kumbaro, Lindita Nikolla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj, Shezai Rrokaj.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Në fakt, do të na duhet të rikthehemi edhe një herë te pjesa e axhendës, të cilën e diskutuam dhe u dakordësuam në parim që unë, Milva dhe Fideli do të bënim një propozim për kalendarin, të paktën 2-javor, të komisionit dhe më tej do t’jua dërgonim juve.

Gjithsesi, dje në drekë pas mbledhjes së Asambleve të Pedagogëve nuk ramë dakord për mënyrën e procedimit të dëgjësës me pedagogët, prandaj vendosëm të mbledhemi sot në orën 10:00, për të diskutuar dhe miratuar kalendarin 2-javor të komisionit, si dhe për t’u dakordësuar në lidhje me ftesën që Asambleja e Pedagogëve ka bërë dje në drekë pas përfundimit të mbledhjes.

Unë i kam dërguar një draft-propozim kryesisë së komisionit dhe do të doja të binim dakord së bashku për ta kaluar. Nesër në drekë në orën 12:00 do të zhvillohet dëgjesa me ministrin e Brendshëm, Sandër Lleshaj, e kërkuar nga 8 deputetë të opozitës, në lidhje me dhunën e ushtruar brenda ambienteve universitare. Është marrë konfirmimi nga ana e ministrit, i cili do të jetë prezent së bashku me stafin e tij nesër në orën 12:00.

Gjithashtu, në bazë të asaj që unë i kam dërguar kryesisë së komisionit kemi propozuar që ditën e premte, në orën 10:00, të bëjmë dëgjësën me pedagogët, si dhe do të bëjmë një dëgjësë me studentët, sikurse edhe jemi dakordësuar në parim sa i takon kësaj dëgjese. Këtë dëgjësë mund ta bëjmë nesër para orës 12:00, ose të premten të bëjmë dëgjësën me pedagogët në fillim më vete dhe, më pas, dëgjësën me studentët, por kjo gjë duhet dakortësuar.

Më tej, për ditën e hënë kemi propozuar një dëgjësë me ministren e Arsimit për të gjitha çështjet e arsimit të lartë, protestën e studentëve dhe paktin e universitetit, dhe pas dëgjësës me ministren e Arsimit, ditën e hënë ose të martë, do të bëjmë diskutimin në parim të amendimeve të propozuara nga grupi i LSI-së për ligjin e arsimit të lartë, diskutimin nen për nen dhe votimin e amendimeve të LSI-së.

Pak a shumë, me aq sa kam diskutuar me Milvën, është rënë dakord, përveç faktit që do të flitet me ministren e Arsimit për të na konfirmuar se kur e ka të mundur ministrja ardhjen në komisionin tonë, ditën e hënë apo të martë. Ne jemi në dispozicion sipas orarit që ministrja do të ketë mundësinë për të ardhur, por vetëm do t’ju lutesha që kushdo që do të mund të komunikojë

me ministren, të na sigurojë se ajo nuk do të shkojë gjëkund, pasi kemi shumë çështje për të diskutuar, të cilat janë lënë përgjysmë, çështje shumë sensitive sa i përket edhe grevës së pedagogëve, VKM-ve, ligjit, studentëve e të tjera.

Fjalën e ka zonja Ekonomi.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Ne dje ramë dakord për dëgjesat, por ndërkohë nuk ramë dakord për procedurën e thirrjes së të ftuarve. Të gjithë së bashku dakordësuam që të kishim një listë emërore, por këtë listë emërore nuk arritëm dot ta hartonim. Pra, përveç pjesës së dakordëimit për ata që do të vijnë në dëgjesë, duhet të vendosim edhe procedurën e thirrjes. Procedura e thirrjes bazohet në ligjin për arsimin e lartë dhe në statutin e Universitetit të Tiranës. Pra, duke pasur të dyja këto akte në dorë, duhet të dakordësohemi për procedurën e thirrjes së individëve që do t'i kemi të pranishëm në dëgjesë.

Ne jemi dakord sa i takon kalendarit. Kalendarit që kemi propozuar përmban një dëgjesë me studentët dhe pedagogët, dëgjesë me ministrin Lleshaj, dëgjesë me ministren e Arsimit. Sa i takon dëgjesës me ministren e Arsimit, meqenëse situata e ekzekutivit në këto momente ka ngarkesë, sugjeruam që para se ajo të thirret në këtë dëgjesë, të negociojmë me të për kohën dhe mundësitë që mund të ketë për të qëndruar sa më gjatë me ne, meqenëse kemi shumë pyetje, ndërsa sa u takon çështjeve të tjera, mendoj të vazhdojmë me procedurën se si do të biem dakord për thirrjen në dëgjesë të përfaqësuesve. Sa i takon kësaj çështjeje, duhet të mos harrojmë se për këtë na shërben edhe neni 36 i Rregullores, ku ne kemi të drejtë të bëjmë dëgjesa dhe të vendosim edhe për procedurën e thirrjes së njerëzve në dëgjesë.

Albana Vokshi – Faleminderit, Milva!

Doja të bëja një sqarim. Ne gjithmonë kemi proceduar në komision ndaj kujt do që ka kërkuar dëgjesë, duke i dhënë hapësirë. Kushdo që ka pasur një çështje, qoftë edhe një qytetar apo një OJF, një kompani, një artist, një gazetar, i cili ka pasur një shqetësim dhe i është adresuar komisionit, ne u kemi dhënë hapësirat e mjaftueshme për të trajtuar një çështje, kuR ne, si komision, një pjesë jona apo të gjithë e kemi konsideruar të rëndësishme. Në fakt, debati për të cilin jemi mbledhur këtu dhe po diskutojmë, ka të bëjë me faktin se cilët nga pedagogët duhet të ftojme. Për këtë arsye, unë iu referova ftesës publike që na është bërë dje si Komisioni i Edukimit...

(Diskutime pa mikrofon.)

Prandaj nuk kemi rënë dakord, se ishte pas mbledhjes.

Asambleja e Pedagogëve pas mbledhjes ka bërë një deklaratë publike së cilës, më lejoni t'i referohem, dhe ajo që ne kërkojmë është që t'i përgjigjemi kësaj ftese, e cila është specifike.

Asambleja ka kërkuar:

1. Rikonfirmimin e kërkesave të bëra më herët.
2. U bëjmë thirrje të gjitha asambleve të mbajnë një qëndrim për ligjin e arsimit të lartë dhe u kërkojmë të bashkohen me vendimin e asambleve që janë për grevë.
3. U kërkojmë të gjitha autoriteteve të mbajnë qëndrim konsekuent për ligjin e arsimit të lartë në përputhje me vendimet e asambleve.
4. Ftojme trupën akademike që të kontribuojnë dhe të kenë një angazhim sindikalist.
5. Ngritja e grupit të punës për ligjin e arsimit të lartë.
6. Kërkojmë debat në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik për ligjin e arsimit të lartë.

Kjo është një ftesë publike, specifike, e mbledhjes së asambleve dhe ne duam t'i përgjigjemi kësaj ftese, si dhe jemi të hapur për këdo pedagog tjetër që do të dojë të debatojë, të hapë një debat dhe të diskutojë këtu për çështje të ndryshme sa i takon ligjit të arsimit të lartë apo për arsimin e lartë në përgjithësi.

Zoti Boçi, e ka fjalën.

Luçiano Boçi – Faleminderit!

Debatin që kërkon nënkryetarja e komisionit e konsideroj të tepërt, pasi jemi në kushtet kur një grup interesi, në këtë rast asambleja ose përfaqësues të asamblesë, kanë kërkuar seancë dëgjimore.

Ne jemi komision parlamentar dhe veprojmë sipas Rregullores, dhe ligjeve që rregullojnë funksionimin e parlamentit dhe të komisionit tone, dhe nuk mund të themi këtu se ne na pengon statuti i universitetit, i cili nuk ka lidhje me ne...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Nuk tha njeri që na pengon, të lutem!

Luçiano Boçi – Ju thatë se na pengon që të përcaktojmë emrat dhe procedurën...

(Diskutime pa mikrofon.)

Neve nuk na detyron as statuti i universitetit që të përcaktojmë procedurën e thirrjes dhe as ligji i arsimit të lartë. Të dyja këto dokumente, ligji, se statutin nuk e diskutoj, do t'i diskutojmë këtu se çfarë deficencash kanë, si mund të rregullohen e të tjera, por në veprimtarinë tonë nuk u

nënshtrohem atyre, sepse ato rregullojnë veprimtarinë e institucioneve dhe grupeve të interesit të ndryshme nga ne. Ne jemi para kërkesës së një grupi interesi, i cili kërkon të vijë në komisionin parlamentar, sepse ne duhet të mbrojmë interesin publik dhe interesi publik në këtë rast mbrohet nga një trup pedagogësh që janë përfaqësues të një asambleje.

Unë habitem me faktin pse duhet të futem unë se kush janë emrat, sepse mua nuk më intereson fare as se kush janë emrat dhe as se kush është vokacioni i tyre grevist, bojkotues apo politik. Ata duan të vijnë këtu dhe të shprehin mendimet e tyre në lidhje me një debat shumë të gjerë publik siç janë: bojkoti i universiteteve, greva e studentëve, amendimi i ligjit të arsimit të lartë. Ta fusim në debatin tonë në kalendat greke me qëllimin për ta zvarritur dhe për ta hedhur poshtë këtë lloj debati, kjo më duket e tepërt. Nuk e kemi kërkuar ne, sepse është ndryshe po ta kërkojmë ne. Çfarë përcaktojmë ne? Ne do të përcaktojmë se nëse do të thërrasim rektorët, atëherë do të bëjmë listën e rektorëve; nëse do të thërrasim dekanët, do të bëjmë listën e tyre dhe këtu përfundon detyra jonë. Pedagogët vijnë me vullnetin e tyre të lirë dhe kanë kërkesat e tyre...

(Diskutime pa mikrofon.)

Të lutem, se do të dal edhe aty!

Në qoftë se shkojmë te Asambleja e Pedagogëve, ligji nuk thotë asgjë për asamblenë. Në statut flitet thjesht për përbërjen dhe jo se kush e thërret apo kush nuk e thërret, kjo nuk thuhet fare. Sa i takon pjesës se kush e drejton, ligji nuk shprehet fare për këtë gjë, por lihet evazive...

Neni 42 cakton qartë kompetencat e dekanit dhe nuk është decani, sipas ligjit, drejtuesi i asamblesë. Vilma, po të jap të drejtë ty, po të them se ligji nuk e jep fare këtë gjë, e lë në mënyrë evazive, ua lë statuteve dhe statutet e rregullojnë vetë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Këtë gjë jam duke thënë, prandaj më dëgjoni deri në fund, ju lutem!

Kjo gjë është e përcaktuar në statut, por aty ka edhe një pikë. Ashtu sikurse ne, që me 1/3 e firmave thërrasim seancat dëgjimore, edhe Asambleja mbledhet me 1/3-ën e firmave, asambleja mbledhet vetë, pa praninë e dekanit, sepse nuk është fare e nevojshme që dekani të jetë i pranishëm. Asambleja në këtë mënyrë ka vepruar gjithmonë, si dhe ka përfaqësuar e vet të firmëtarëve. Nuk ka arsye të ngatërroheni, se asambleja ka firmëtarët e vet, si dhe ka të drejtë t'i paraqesë kërkesat në autoritetin e asamblesë.

Pra, një autoritet akademik, sot i ka dërguar një kërkesë Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Çfarë duhet të bëjmë ne? Nuk ka arsye pse të bëjmë debate kot dhe t'i

bëjmë gjërat lësh. Të vijë kush të dojë në komision dhe ne duhet t'i dëgjojmë, sepse nuk i përcaktojmë ne emrat. Le të vijnë 10 apo 30 veta, ne kemi durimin, detyrën publike, detyrën funksionale parlamentare t'i dëgjojmë. Nuk do të bëjë selektim as Luçiano, as Musai, as dikush tjetër, më fal Musa, se përmendja e emrit është pak problem në të tilla raste, por thjesht do të dëgjojmë pedagogët sa i takon interesit të madh që ata kanë për funksionimin e universitetit publik, për ligjin e arsimit të lartë dhe për grevën e studentëve. Unë nuk e kuptoj pse hezitoni dhe pse duhet të futemi në këto kalenda, madje edhe këtë mbledhje të ditës së sotme e konsideroj të tepërt; kjo është si ajo shprehja "Me u gjet Kola në punë". Pra, vijmë këtu në komision, bëjmë zhurmë dhe...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Gjithë këto kamera për kalendarin...

Luçiano Boçi – Po, gjithë këto kamera për kalendarin, se i thirrët...

(Diskutime pa mikrofon.)

Publicitetin e bëjmë mirë ne, sepse ju bërtisni për kalendarin dhe thoni: "Çfarë pune keni ju me kalendarin, e cakton kryesia!"..

(Diskutime pa mikrofon.)

Një minutë Musa, se ti bërtet më shumë se Milva, ti je problemi kryesor...

Albana Vokshi – Kur nuk dakordësohet kryesia, atëherë vjen në komision...

Luçiano Boçi – Albana, është e tepërt të diskutohet...

Albana Vokshi – Nuk duan, kanë frikë, çfarë t'ju them!..

Luçiano Boçi – Kjo që është këtu, nuk është propozimi i grupeve, as i LSI-së apo yni, por është kërkesë e përfaqësisë së asamblesë e bërë publike, kështu që ne jemi të detyruar me një këmbë të mbledhemi, sepse ne përfaqësojmë interesin publik. Kjo është mëse e thjeshtë dhe nuk ka nevojë për debat.

Do të përcaktojmë ne procedurën?! Çfarë procedure...

Milva Ekonomi – Asambleja ka një përfaqësues...

Luçiano Boçi – Jo një përfaqësues, por janë të gjithë ata që kanë firmosur thirrjen, siç jua shpjegova...

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem!

Luçiano Boçi – Në statut është e përcaktuar që kur e thërret dekani, në qoftë se dekani ka thirrur asamblenë, dekani do të na e kishte bërë kërkesën ne dhe ne do të kishim përpara...

Milva Ekonomi – Mbledhja e asamblesë është e pavlefshme, sepse nuk ka qenë 50% e pedagogëve në asamble...

Luçiano Boçi – Musai të lavdëroi, tha se je shumë e urtë, prandaj mos e përmbys opinionin e tij, jo timin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Milva, të lutem, mos ndërhyri, se bëni figurë të keqe edhe para pedagogëve!

Luçiano Boçi – Pra, në qoftë se do të ishte iniciator dekani i X fakulteti apo i disa fakulteteve, do të isha dakord. Edhe një herë, kur është fjala për statutin, do të japim sqarime këtu për 1 apo 2 orë...

Albana Vokshi – Mirela, kur ta marrësh fjalën, fol 5 orë, nuk kemi orare...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ta respektojmë njëri-tjetrin, sepse Milva nuk po e lë zotin Boçi ta mbaroj fjalën e tij.

Luçiano Boçi – Unë po ju sqaroj se asambleja thirret nga një përfaqësi me 1/3-n e firmave. Janë këta që e drejtojnë asamblenë, mbajnë rendin e ditës dhe ngrenë shqetësimet. Këto shqetësime që janë ngritur, ata i kanë bërë publike, duke i dërguar edhe pranë komisionit tonë, prandaj ne duhet t'i pranojmë dhe t'i dëgjojmë. Sa u takon debateve të tepërta, hajdeni të bëjmë sherr, se kemi kamera, duke treguar atë pjesën tonë, sepse siç e keni zakon ju në fund fare thoni: “ta hedhim në votim”. Çfarë do të hidhnin në votim? Nuk keni se çfarë të hidhni në votim, se e kanë kërkuar ata e jo ne. Nuk keni si ta hidhni në votim kërkesën e tyre!

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Kolegë, dua t’ju sjell në vëmendje se çfarë vendimi morëm dje. Ne dje morëm një vendim për të thirrur në dëgjese Asamblenë e Personelit Akademik. Pra, për të thirrur në dëgjese përfaqësuesit e Asamblesë në komision, u ra dakord që përfaqësuesit e tri palëve politike do të bënin një listë me emrat...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ndërkohë, gjatë zhvillimit të mbledhjes, nëpërmjet komunikimeve doli, pa dalë ende deklarata, që ata kishin vënë një kërkesë, dëgjuesën me komisionin. Në nenit 41të ligjit “Për arsimin e lartë” thuhet: “Asambleja e Personelit Akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të

plotë i njësisë kryesore”. Ne kemi një statut për universitetin dhe në këtë statut thuhet: “Mbledhja e Asamblesë e Personelit Akademik zhvillohet kur në të janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë 50+1% të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Mbledhja ka pasur, sipas asaj që kemi parë në televizion, më pak se gjysmën e personelit akademik me kohë të plotë.

Albana Vokshi – E numërove ti se sa ishin aty?!

Milva Ekonomi – Vendimi që ata kanë sjellë këtu është një vendim jo i drejtë, prandaj ju themi të thërrasim Asamblenë e Akademikëve të vijë në dëgjesë, sipas ligjit dhe statutit. Në ligj dhe në statut thuhet: “Ai që drejton këtë asamble është dekani i fakulteteve”. Pra, për këtë arsye dekanit të fakulteteve, ashtu siç e vendosëm edhe dje, është mirë t’i bëjmë një kërkesë për të dërguar këtu përfaqësuesit e Asamblesë. Ne jemi përpara këtij fakti që e vendosëm dje, për të pasur...

Albana Vokshi – Milva, ne nuk kemi vendosur asnjë gjë dje, hap procesverbalin dhe lexoje..

Milva Ekonomi - ... përfaqësues të Asamblesë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Dje vendosëm të bënim një listë, ne të tre morëm vendim dje të bënim një listë, por nuk ramë dakord...

Albana Vokshi – Jo, merr shiko procesverbalin, sepse nuk ramë dakord për këtë...

Milva Ekonomi – Për listën ramë dakord, megjithatë shohim edhe procesverbalin.

Ne mendojmë se duhet thirrur asambleja në dëgjesë...

Albana Vokshi – E para...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva, të lutem, me qetësi, jemi duke folur për arsimin e lartë dhe ta respektojmë njëri-tjetrin!

(Diskutime pa mikrofon.)

... po ngatërroi shumë gjëra. Jeni mësuar të kontrolloni gjithçka, jeni mësuar t’i jepni urdhër gjithkujt dhe kur ju dalin jashtë urdhrave dhe rreshtimit, bëheni keq. Siç duket, Asambleja

e Pedagogëve, greva, ju ka çoroditur krejtësisht dhe nuk po e kuptoni se qoftë edhe një pedagog po kërkoi dëgjuesë në komisionin tone, jemi të detyruar ta dëgjojmë, sepse për këtë punë jemi...

Milva Ekonomi – Jo, për këtë rast...

Albana Vokshi – Milva, të lutem, pak respekt, mos ndërhy!

Kush ka shkuar dhe paska mbajtur numrat sa ishin, ishte 1/3-a, gjysma e të tjera? A e kuptoni se çfarë po bëni? Jeni kthyer në kohën e ish-Sigurimit të Shtetit, ku mbani shënim dhe spiunoni. A e kuptoni se ku po shkoni?

Po jua sqaroj shumë qartë: kanë dërguar një ftesë publike organizatorët e mbledhjes së asambleve. Të gjithë ata janë profesorë të nderuar dhe nuk janë me parti, prandaj mos i bëni lëmsh gjërat...

(Diskutime pa mikrofon.)

Rri shih Vlorën, aman!..

Ftesa është bërë publike, prandaj duam të dëgjojmë ata që kanë dërguar ftesë publike. Në qoftë se doni të njëjtën ditë, atëherë dërgojmë nëpër rektorate apo nëpër dekanate një ftesë dhe i thërrasim dekanët, rektorët. E doni një të njëjtën ditë? Në rregull, e bëjmë në të njëjtën ditë. E doni në ditë të ndryshme? Në rregull, e bëjmë në ditë të ndryshme; edhe këtë gjë do ta bëjmë, prandaj mos e kini fare problem. Çdo dekanati dhe çdo rektorati do t'i shkojë ftesa për të ardhur dhe për të diskutuar çështje të arsimit të lartë, çështje të situatës në arsimin e lartë, çështje të dështimit pas ligjit të arsimit të lartë, kë të doni ju. Ne sot duam t'i përgjigjemi ftesës së djeshme të Asambleve të Pedagogëve dhe këtë ne nuk duhet ta diskutojmë fare. Jemi mbledhur për një gazetarë e jo për Unionin e Gazetarëve!...

Milva Ekonomi – Natyrisht që do t'i thërrasim, por ftesa do të jetë ajo që u propozua dje.

Albana Vokshi – Sot jemi për t'iu përgjigjur ftesës së Asambleve të Pedagogëve. Nëse doni të bini dakord në rregull; nëse jo, ne e kemi mekanizmin, por do të donim të ishim bashkë. Mos i shihni të gjithë pedagogët si armiq, se nuk po u binden urdhrave tuaja, sepse janë për të mirën e përbashkët, por merrini...

Milva Ekonomi – Përfaqësuesit e një pjese, jo të të gjithëve...

Albana Vokshi – Atë pjesë ta dëgjojmë, se na kanë kërkuar debat, të tjerët nuk kanë kërkuar. Ata që ju i keni nëpër lista, nuk kanë kërkuar debat. I doni ju, atëherë i ftojme një ditë tjetër, këtë po ju sqaroj. A biem dakord për këtë të parën, ftesën?

Milva Ekonomi – Të biem dakord për atë që vendosëm dje, pastaj për këtë që kemi si kërkesë sot, sepse edhe nderet kanë radhë. Ne kemi një radhë, në fillim duhet të thërrasim në dëgjues Asamblenë, pastaj kemi një kërkesë nga grupi organizator i Asamblesë. Pse nuk bëhen gjërat me radhë? Radha është Asambleja dhe pastaj...

Albana Vokshi – Kush e bën radhën?

Milva Ekonomi – Ne, se e diskutuam dje...

Albana Vokshi – Milva, çfarë paske sot...

Kejdi Mehmetaj – Mua më vjen keq që po zhvillohet ky lloj debati dhe në këtë lloj forme, sepse besoj se nuk i shkon për shtat asnjërit prej nesh, duke marrë parasysh që po flasim për protestat, profesorët dhe për pedagogët. Që të jemi të qartë me njëri-tjetrin, këtë do ta shohim edhe nga procesverbalet, por ne dje ramë dakord që do të bëjmë disa dëgjues. Në mos gabo, diskutuam për konferencën e rektorëve, senatet, asamblëtë, ku asnjëri nuk e përjashton tjetrin, prandaj unë nuk e kuptoj se kush janë ata që na detyrojnë të bëjmë një renditje dhe të thërrasim ose njërin, ose tjetrin. Dje kanë qenë të mbledhur mbi 200 profesorë. Çfarë rëndësie ka se çfarë përfaqësojnë këta profesorë, asamble, sindikatë, universitete të ndryshme? Ata janë profesorë që kanë ngritur një shqetësim, që lidhet me ligjin për arsimin e lartë; na pëlqen ose jo ne, kanë ose jo të njëjtat mendime me ne, nuk ka rëndësi. Pse duhet t'i hyjmë diskutimit ishin gjysma ose jo?

Më falni, Milva, por po e vrasim autonominë e universitetit pikërisht duke u marrë me mungesat e tyre, janë gjysma apo nuk janë gjysma, kanë apo nuk kanë vendime! Ata janë disa personazhe të nderuara të universitetit, që kanë një mendim për një temë, që është edhe jona për diskutim dhe, si vendimmarrës, kemi detyrimin t'i thërrasim dhe t'i dëgjojmë. Kjo nuk e përjashton që nesër të bëjmë një ftesë për dekanët, të ftojme senatet, rektorët. Pse duhet ta bëjmë ne këtë lloj diskutimi? Ne nuk duhet të kemi frikë të dëgjojmë njerëzit, kushdo qofshin ata. Kështu që unë them të vëmë në pikën e parë të rendit të ditës dëgjuesën me këtë grup që na e kërkoi. Ata duhet të vijnë dhe t'i dëgjojmë të gjithë se çfarë kanë për të thënë, të dëgjojmë qëndrimet e tyre në raport me ligjin dhe situatën që është krijuar, madje unë mendoj të thërrasim edhe shoqërinë civile. Për mua është gabim shumë i madh që ne t'iu marrim mungesat profesorëve dhe të hapim statutin e senatit. Po ç'punë kemi ne me statutin e Universitetit të Tiranës? Nuk është fare në përgjegjësinë tonë kjo gjë. Ne kështu po ndërhyjmë drejtpërdrejt tek universiteti. Nuk ka rëndësi çfarë emri ka grupi i interesit, ta dëgjojmë këtë grup interesi, madje mund të vijnë edhe të tjerë dhe ne duhet t'i dëgjojmë.

Mirela Kumbaro – Unë e kam më shumë të natyrës procedurale komentim, në fakt, edhe për të ulur pak tonet me të cilat po diskutohet.

Kryesia e komisionit ka bërë dhe një bisedë që na u raportua nga ju, por na u raportua edhe nga zonja Ekonomi dhe që në kushtet e padakordësisë midis ju të treve, ftoni komisionin për ta diskutuar.

Së pari, duhet të ulim tonet, sepse po shkëmbejmë mendime dhe nuk kemi nevojë as të bërtasim, as të insinuojmë, as të përziejmë pedagogët me parti ose pa parti. Më çuditë pak ky lloj cilësimi, nuk më kishte shkuar mendja, por subkoshienca flet. Pra, nuk ka nevojë të bëjmë një shou për të mbushur orarin e lajmeve: u bë debat, u bë sherr. Ky komision komunikimi nuk duhet të kthehet, siç rëndom është kthyer, në komision moskomunikimi.

Në lidhje me gjashtë pikat e bëra nga asambleja ose nga një grup pedagogësh, unë jam dakord me zonjën Mehmeti kur thotë që, edhe nëse një grup pedagogësh duan të mblidhen dhe të diskutojnë, pa qenë asamble domosdoshmërisht, pa përmbushur kriteret e ligjit, të nenit 41, ose të statutit të universitetit, kanë të drejtën të diskutojnë dhe të flasin, dhe t'i bëjnë publike qëndrimet e tyre.

Ky grup pedagogësh në gjashtë kërkesat e tyre kërkojnë edhe një debat me komisionin tonë për ligjin për arsimin e lartë. Tani, me qëllim që ne të mos rrahim ujë në havan dhe të mos harxhojmë orë qoftë të tyret, qoftë tonat, por edhe të autoriteteve shtetërore deri në nivel ministri, a mundet të kuptojmë për çfarë bëhet fjalë? Sepse nuk bëhet fjalë për diskutimin e të gjithë ligjit. Kemi një kërkesë për amendim nga zonja Mehmetaj, një javë më parë, për tre, katër ose pesë nene. Të diskutojmë për to, i pranojmë, nuk i pranojmë, i ndryshojmë, i modifikojmë. Pra, unë dua të jemi shumë të qartë për procedurën. Çfarë do të diskutojmë? A do të diskutojmë për të gjithë ligjin? A kemi një propozim nga ky grup për ndryshimin e 3 neneve ose të një neni? A kemi një draft tjetër që vjen për diskutim dhe ne duhet të marrim kohën e duhur që ta konsultojmë? Mua më duket jo efikase që të flasim për të gjithë ligjin në përgjithësi. Nëse është për të bërë *shou*, më duket jo efikase; nëse keni diçka konkrete, ju lutem, na e thoni, ose t'ua kërkojmë organizatorëve që të na thonë se çfarë duan. Në finale përtej grupit të pedagogëve, ka një masë shumë më të madhe, që është e gjithë bota universitare, që janë studentët, pedagogët, punonjësit asistentë dhe secili nga ata ka një gur në mozaikun e botës universitare. Komisioni ynë duhet t'i ketë në vëmendjen e tij të gjitha grupet. Këtë mund ta bëjmë duke kanalizuar kërkesat e të gjithëve: të grupit të studentëve, që janë duke bërë mësim në universitete dhe në fakultete të ndryshme; të VKM-ve, të cilat janë në

zbatim dhe kanë nevojë për mbështetje, për ndjekje nga komisioni ynë; të grupit të pedagogëve që nuk duan të bëjnë mësim, të cilët, në fakt, grevën e kanë në raport me punëdhënësin e tyre, nuk e kanë në raport as me komisionin, as me qeverinë. Greva është një nocion të cilin punëmarrësi ia bën punëdhënësit.

Albana Vokshi -Ju lutem, zonja Kumbaro, u ankuat për të tjerët që flisnin gjatë. Ju lutem, mos debaton.

Mirela Kumbaro- Unë nuk po debatoj, madje më të qetë dhe më të respektueshme se unë ndaj të gjithëve nuk ka.

Prandaj, nëse jeni këtu për të bërë *shou*-n politik të javës, vazhdoni, është puna juaj, e keni bërë gjithmonë dhe do të vazhdoni ta bëni.

Në këtë sallë jemi shumë pedagogë, ndaj unë u bëj thirrje, së pari, zotit Rrokaj, zotit Boçi, të gjithë kolegëve të djathtë dhe të majtë, ta sqarojmë këtë gjë, të biem dakord t'iu kërkojmë organizatorëve të na i saktësojnë problemet që kanë, që ne të përgatitemi më mirë edhe t'ju japim përgjigje të saktë.

Albana Vokshi - Zonja Kumbaro, ju në dy vjetët e fundit nuk keni ndjekur se çfarë problemesh ka pasur ligji i arsimit të lartë dhe çfarë shqetësimesh ka pasur gjithsecili prej atyre çdo ditë, sepse keni qenë e ngarkuar me pjesën e kulturës. Unë i kam dëgjuar çdo ditë pedagogët dhe studentët si po e vuajnë situatën në arsimin e lartë. Kanë aq shumë problematika, sa që nuk mendoj se ne duhet t'iu kërkojmë atyre çfarë problemesh kanë. Ata edhe ditët e fundit i kanë përcjellë problemet. Unë i kam dëgjuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më pyetët për procedurë si do të veprojmë.

Mirela Kumbaro – Unë nuk ju pyeta, unë shtrova një çështje për procedurë, por ju nuk mund të më thoni se unë nuk e kam ndjekur situatën, sepse unë kam 29 vjet të jetës sime në universitet, zonja Vokshi.

Albana Vokshi – Tani, ju lutem, a mund ta marrë fjalën zonja Duka?

Mirela Kumbaro – Unë ju konfirmoj që e kam ndjekur edhe ligjin, edhe debatet.

Valentina Duka - Unë do ta filloj nga thirrja që bëri zonja Kumbaro për pedagogët që janë këtu. Sigurisht që këtu jemi shumë pedagogë. Unë, në fakt, isha përgatitur për të bërë një thirrje: të bashkohemi të gjithë për t'i kërkuar Kryeministrit të heqë dorë nga të gjitha sulmet ndaj rektorëve, ndaj dekanëve, ndaj pedagogëve të universitetit, sepse, sado gabime të kenë bërë në

jetën e tyre, stafet akademike të universiteteve kombëtare janë asete kombëtare, janë njerëz 1000 herë më të nderuar se politikanët. Unë po ju them se më shumë isha e nderuar kur punoja si pedagoge sesa tani si politikane.

Po ju tregoj një rast: pardje kam pasur ditëlindjen dhe kisha një ditëlindje shumë të rëndësishme, kisha 60-vjetorin. Në raste ditëlindjesh, kur kam qenë pedagoge universiteti, kam pritur vetëm lule nga ish- studentë, pedagogë dhe kolegë, si politikane jo vetëm që nuk kam marrë asnjë trëndafil, por jam shumë e lumtur që nuk kam marrë një thes me plehra, sepse me plehra ka qenë vazhdimisht i mbushur parlamenti nga pikëpamja *online*, nga media sociale, për shkak të gjuhës që përdoret, sidomos të goditjeve që marrin politikanë të ndryshëm në ambientet e parlamentit. Për këtë jam shumë e lumtur që ai kosh nuk më erdhi në shtëpi.

Së dyti, dua të mblidhemi të gjithë, 7-8 pedagogë që jemi këtu, të bëjmë një deklaratë në mbrojtje të stafëve akademike. Kryeministri duhet të heqë dorë nga goditja e rektorëve. Po ç'punë ka ai të ndërsejë studentët kundër rektorëve, kundër pedagogëve, kundër dekanëve?! Si mund t'i drejtohet ministres së Shëndetësisë sikur të ishte rektore e Universitetit të Mjekësisë?! Po ku merr vesh ministrja e Shëndetësisë nga kurrikulat universitare?! Ato në të gjithë botën janë ekskluzivitet i universitetit. A shkoi Merkeli ndonjëherë të marrë mikrofonin dhe të shajë pedagogët, sado defekte të kishin ata? Ata janë asete kombëtare, prandaj të gjithë duhet të mbështetim pedagogët. Ata mund të kenë bërë gabime, por, edhe nëse kanë bërë, përqindja e gabimeve të tyre është shumë e vogël në krahasim me përqindjen e gabimeve të klasës politike. Pedagogët nuk e kanë mbushur Shqipërinë me kanabis, nuk po i dëbojnë ata studentët.

Albana Vokshi – Studentët po largohen nga vendi i tyre.

Valentina Duka – Studentët janë produkt i pedagogëve. Ne jemi produkti i të gjithë pedagogëve, të cilët duhet t'i shohim me respekt, prandaj të gjithë këtu duhet të ngremë zërin kundër politikës që po godet përditë e më shumë pedagogët për të fshehur gabimet dhe bëmata e veta. Duhet t'i dëgjojmë pedagogët. Nuk ka fare rëndësi nëse janë 50% përfaqësues të një asambleje ose 100%.

Pse Ministria e Arsimit i priti pedagogët si përfaqësues të asambleve? Atëherë t'i presim dhe t'i dëgjojmë edhe ne. Nëse do të mbështesim “Paktin për universitetin”, ne do të shkatërrojmë autonominë. Pedagogët nuk kanë frikë VKM Nr. 777, siç thuhet, sepse kur nuk kanë frikë politikanët nga vetingu, pedagogët nuk bëhen merak fare.

Fidel Ylli – Unë dua të ndalem në 2-3 gjëra konkrete. Studentët na dhanë një mësim shumë të mirë në politikanëve e, sidomos, në të Komisionit të Medies. Na dhanë një mësim shumë të mirë në të majtëve, por edhe ju të djathtëve, që nuk na pranuan në ambientet tuaj për t'u bashkuar me ta.

Albana Vokshi – Çfarë lidhje ka Komisioni i Medies?

Fidel Ylli- Ka lidhje Komisioni i Medias, sepse ne jemi pjesë e politikës. Studentët nuk i pranuan përfaqësuesit e politikës.

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Unë nuk e kuptoj se çfarë lidhje ka Komisioni i Medies me këtë, por ta dëgjojmë, ju lutem!

Fidel Ylli – Ne, deputetët e Komisionit të Medias, Edukimit dhe Arsimit, jemi pjesë e politikës. Studentët nuk e pranuan politikën. Sado që ne përpiqemi të bëjmë politikë këtu, unë ju sfidoj dhe ju them bëjini listat me studentë dhe pedagogë, por mos harroni se janë 100 mijë studentë dhe për arsye teknike, nuk mund t'i presim dot të gjithë. Unë ju ftoj t'i sillni ata pedagogë dhe studentë që doni ju, nuk ka asnjë problem për ne, sepse ne ju sfidojmë ju themi “sillni kë të doni”. Ne jemi të prirur t'i dëgjojmë me vëmendje. Mos ngatërroni protestën e 16 shkurtit me protestën e studentëve! Protesta e 16 shkurtit është gjë tjetër. Mblidhni njerëzit, është e drejta juaj të protestoni, por mos e ngatërroni këtë histori, siç e bëtë me ministren e Arsimit, që e ftuat, sipas procedurës për dy çështje që ngriti zonja e LSI-së dhe i bënit pyetje që nuk kishin lidhje fare me atë për të cilën e kishim ftuar. Ministria, në fakt, jua tha që më thërrisni në komision, bëni pyetjet dhe ju përgjigjem për çfarë të doni.

Albana Vokshi - Të hënën.

Fidel Ylli- Ne ngatërrojmë të gjitha procedurat dhe vetëm politikë bëjmë, prandaj nuk i zgjidhim dot problemet e studentëve.

Albana Vokshi – Të hënën vjen edhe ministria.

Fidel Ylli- Po, të hënën do të vijë edhe ministri i Brendshëm, edhe Kryeministri.

Albana Vokshi– Këtë punë kemi ne.

Fidel Ylli– Po mos thoni që kemi frikë. Ne po ju themi që hajdeni të diskutojmë, hajdeni edhe ta rrëzojmë ligjin për arsimin e lartë, por ai është ndër ligjet më të mira. Nëse ka gjëra që kanë të bëjnë me vendimet e qeverisë, me aktet nënligjore, hajdeni t'i diskutojmë pse nuk ka funksionuar ligji, por, në fakt, ligji për arsimin e lartë është shumë i mirë.

Albana Vokshi- Ky qenka ligji më i mirë, por studentët janë në protestë, universitet janë në grevë, aktet nënligjore ende sot pas dy vjetësh nuk kanë dale! Dikush duhet të mbajë përgjegjësi. Përgjegjësit duhet të mbajnë përgjegjësi, sepse ky ligj u ka shkaktuar studentëve dhe pedagogëve një mal me probleme, kosto financiare dhe shpirtërore. Pra, si mund të thoni ju që është një nga ligjet më të mira kur studentë dhe pedagogë janë në grevë?!

Fideli Ylli- Studentët ta kërkojnë të drejtën te senati.

Albana Vokshi – Jo, ta kërkojnë këtu, se ne jemi ligjvënësit!

Shezai Rrokaj- Arsimi është pasuri kombëtare. Çdo forcë politike që kërkon ta kapitalizojë për interesat e veta, bën gabim fatal. Ne kemi për detyrë që për çështje të reformave kombëtare, siç është ligji i arsimit të lartë ose reforma në shëndetësi, të kemi vetëm një zë, sepse nuk janë reforma që lidhen me mandatet qeverisëse.

Së dyti, dëgjesa e cilitdo grup përkatësisht, në rastin konkret e profesorëve, është grup interesi. Ne e dimë që nuk ka asamble në rang universiteti, pavarësisht se ndonjë pretendon se e di ligjin. Ata janë grup interesi. Ata janë pritur nga ministrja dhe unë them që të mos i fyejmë më shumë, por mos të ngurojmë t'i dëgjojmë.

Së treti, nga përvoja që kam, ligjet, edhe sikur të përsosura të jenë, në një kohë të caktuar, kur ata zbatohen, krijojnë probleme. Universitet kanë pasur opsionet e tyre për ligjin, të cilat po rezultojnë se kanë një problematikë, përveç problematikës së madhe që universitetet kanë pasur dhe arsimi në tërësi ka pasur me moskujdesjen e të gjitha politikave të qeverisjeve në vitet e tranzicionit. Pra, ka problematika. Më çudit kokëfortësia, por, kur grupe interesi shprehen se duhen dëgjuar, gjëja e parë që duhet është ballafaqimi, pra cilat janë pikat që ky grup interesi kërkon të shikojë. Ballafaqohen pikat me grupin tjetër dhe gjendet një zgjidhje.

Meqenëse diku u tha se morëm shuplakë, diku grusht, në fakt, unë them që të gjithë morëm një mësim të mirë, prandaj gjëja e parë që duhet të bëjmë për të krijuar një vetëdije të plotë, është të dëgjojmë studentët, grupet interesit, titullarët e institucioneve, që edhe ne të kemi një *feed back*, jo, siç na vijnë lajmet nga partitë, por siç grupet e interesit e sjellin. Ju them se bashkohem me Valentinën, sepse baltosja në bllok është parim i regjimeve totalitare. Unë kam qenë rektor dhe i jam përgjigjur edhe Kryeministrit të kohës. Korrupsion ka në universitet, por jo të gjithë janë të korruptuar; ryshfet merret atje, po jo të gjithë paguajnë dhe marrin ryshfet; studentë dhe pedagogë, shumë shesin libra të shtrenjtë, por jo të gjithë e bëjnë këtë.

Do t'i lutesha shumë Kryeministrit të Shqipërisë të heqë dorë nga baltosja *on block*, sepse feja edhe shkolla, edhe sikur të kenë probleme, ruhen si dy gjëra të çmuara të konstitucionit shpirtëror të vendit. Nuk është mirë të krijojë përplasje, sikur çfarë do të ndajmë në këtë vend, kur ne nuk investojmë aq sa duhet për universitetet. Gjëja e parë është: hajde të vendosim që t'i japim shkollës atë që të gjitha vendet ku ne kërkojmë të integrojmë, i japin në përqindje të GDP-së për arsim. Ta fillojmë këtë, por jo të mbetemi te 3 % “dem baba dem”. Do të marrim disa vendime siç i marrin të tjerët? Ejani t'i marrim! Të marrim kostot, por ta bëjmë të dyja krahët, që nesër të mos thonë e mori PS-ja, e mori PD-ja. Këto janë shumë të rëndësishme, ndaj them se paketa ligjore për universitetin duhet riparë. Pse? Ju e dini si zgjidhen anëtarët e bordit. Vetëm një anëtar bordi nga studentët kërkon ndryshim ligjor. Pse i biem vërdallë kot më kot?! Edhe në paketë kërkohen disa ndryshime ligjore, për shembull, nëse do të paguash masterin, ta zëmë, sivjet një pjesë dhe më pas do të vazhdoesh të mos e paguash, kjo ka të bëjë me një ndryshim ligjor, sepse në ligj thuhet që i mbulojnë vetë shpenzimet e tyre. Pra, pse bëheni kaq refraktar, kolegë? Ka një problem: edhe studentët thonë që duhet riparë, edhe pedagogët.

U çudita dje, dhe këtu dua ta mbyll, po flitej për sindikatë të pedagogëve, për grevë. Ore zotërinj, kur pedagogët ngrihen në protestë, shteti dhe shoqëria ka një problem të rëndësishëm, se ata nuk e kanë për zakon të ngrihen. Asnjë universitet demokratik nuk ka sindikatë për profesorët, ka sindikatë për stafin mbështetës e të tjera, por unë kam udhëtuar e kam vizituar me qindra universitete dhe nuk kam parë sindikatë për ata që janë krijues dhe akademikë, sepse ata e kanë bezdi të dalin. Po dolën ata, do të thotë se problemi është majisur, ka rënë kambana e alarmit, unë kështu e shikoj. Duhet të heqim dorë vetëm edhe pse u përkasin bindjeve politike të ndryshme, sepse tanët janë të PS-së, tanët janë të LSI-së e kështu me radhë, pra, ta heqim këtë perde partiake për një të mirë kombëtare siç është arsimi. Kjo është ftesa që ju bëj dhe të mos e zgjasim për t'i thirrur e dëgjuar ata, sepse ne kemi nevojë të vetëdijesohemi më tepër lidhur me çka meriton arsimi.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, profesor!

Në fakt, është e vërtetë puna e sindikatave, por kam përshtypjen që pedagogët janë në një presion aq të madh këto kohët e fundit, në një shantazh aq të madh që po ushtrohet ndaj tyre, ndaj fëmijëve, grave, familjeve të tyre që, nëse dalin dhe ekspozohen apo flasin, kini parasysh që po flasim për elitën e shoqërisë, u rrezikohet puna bashkëshortëve, u rrezikohen studimet fëmijëve, u

rrezikohet çdo gjë tjetër që kanë në familje. Mendoni ku kemi arritur, kur flasim për lëvizje sindikaliste, që në bazë të sindikatave ato të mbrohen me vendin e tyre të punës, minimalisht!

Fjala për zotin Luan.

Luan Baçi – Në linjën e asaj që propozoi zonja Kumbaro me tone të qeta dhe nga ana procedurale: ju keni bërë një mbledhje të kryesisë së komisionit dhe nuk keni rënë dakord për mënyrën se si do të procedojmë për të thirrur pedagogët apo studentët. Sot mbledhemi në komision përsëri për të rënë dakord për të njëjtën çështje. Unë mendoj se edhe mbledhja është e paragjykuar, se edhe maxhoranca do të mbajë qëndrimin e përfaqësuesve të vetë të mbledhjes së kryesisë, edhe ne do të mbajmë qëndrimin që ka mbajtur kryetarja e komisionit. Pak a shumë po bëjmë *show* këtu për të folur për problematikat. Ne duhet të shfrytëzojmë hapësirat ligjore që na jep ligji, si maxhorancës, ashtu edhe ne si opozitë për të diskutuar dhe për të vënë në dispozicionin tonë aq sa na takon të marrim, aq sa mund të na lejojë ligji.

Lidhur me atë që tha zoti Ylli me të drejtë, që ju e keni votuar ligjin e arsimit të lartë, jo, PD-ja nuk e ka bërë këtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si opozitë e keni fjalën? Në këtë drejtim jemi në të drejtën tonë dhe jo pa qëllim në mbledhjen e parë të komisionit, nuk ishim dakord për të diskutuar ato dy amendimet e ligjit të propozuara nga zonjusha Mehmetaj, sepse ne jemi absolutisht për rishikimin e ligjit për arsimin e lartë dhe, në fakt, nuk është ligj që qëndron, është ligj i kontestuar fuqishëm tani nga studentët dhe pedagogët.

Duke e vazhduar më tej argumentin, mendoj se edhe ana procedurale nuk duhet të na pengojnë, as votat tuaja s' duhet të na pengojnë për të dëgjuar të gjithë studentët dhe pedagogët, pavarësisht se ligji apo statuti mund të bëhen pengesë për mënyrën se si ata janë të organizuar. Duke qenë se sistemi universitar tashmë është në një rrëmujë totale, duhet t'i dëgjojmë e pastaj gjithsecili të vendosë sipas fuqisë së votës.

Faleminderit!

Ismet Beqiraj - Përshëndetje!

Më bëri përshtypje që sot po diskutojmë për kalendarin e veprimtarisë së komisionit, kur kryesia jonë e nderuar nuk është dakordësuar. Ka një mbipopullim mediatik, pasi është një çështje sensitive që diskutohet dhe nga ky këndvështrim, edhe unë si pjesë e universitetit ndjehem mirë. Më së fundi, arsimi i lartë dhe binomi student-pedagog, për herë të parë mbas viteve '90 po

diskutohet kaq gjatë dhe me këtë ndjenjë përgjegjësie dhe politike nga të gjitha krahët. Bie dakord me ato tha profesor Rrokaj më parë, që kjo është përgjegjësia e të gjithë politikës deri tani. Unë kam folur personalisht për pedagogët, çështjet dhe problemet e universitetit dhe nuk influencohem e as ndikohem nga cilido presion politik, por ndërkohë, ne dëgjojmë edhe në këtë tavolinë që të dyja krahët kanë ardhur, në radhë të parë, për të bërë politikë dhe mirëpolitikë për ta qeverisur në pozitë dhe opozitë këtë vend, me gjithë problematikat dhe sidomos institucionet e arsimit të lartë. Por ky komision nuk mund të heqë dot dorë nga tradita e tejzgjatur që thjesht për procedurat e një rendi dite të diskutojmë kaq gjatë, që sinqerisht na humbin kohë. Megjithatë, më vjen keq që qoftë nga krahë i maxhorancës dhe nga ai i opozitës, të përgjërohemi, të qajmë me lotë krokodili, të bëjmë sikur s'kemi qenë këtu, pse ndodhemi në këtë situatë, pse ka këto problematika arsimit të lartë. Pra, ne kemi qenë brenda problemit, kemi qenë dhe jemi vetë problemi, këtë duhet ta pranojmë. Ne nuk i kemi marrë në konsideratë, kemi qeverisur ju dhe ne për kaq vite...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Profesor të lutem!

Albana Vokshi – Ju jeni përgjegjësi! Mos shpërndani përgjegjësitë! Ose e ka opozita, ose e kanë dekanët, mbani përgjegjësitë tuaja. Ja ku e keni ministren...

Ismet Beqiraj - Media e nderuar, e shikoni se ç'ndodh në një tavolinë me pedagogë, profesorë, njerëz të nderuar dhe respektuar, nuk bëhet dialog dhe nuk dëgjohemi! Thyhet etika, duke ndërhyrë në fjalën e tjetrit. Unë do të flas siç e mendoj, ju pëlqen apo jo kjo!

Albana Vokshi – Po nuk mund të thuash gjëra të pavërteta, se je ligjvënës dhe mban përgjegjësi për atë që thua!

Ismet Beqiraj - Për dy gjëra ke përgjegjësi, zonjë, se i shqeve dyert e universiteteve, e mbipopullove. Vetëm Fakulteti i Shkencave me kapacitetet që ka, nuk mban më tepër se 1200-1500, ja edhe 2000, por jo 7000 – 8000 studentë...

Albana Vokshi – Juve ju ka mbetur ora mbrapa...

Ismet Beqiraj – E pra, atje më ka mbetur ora mua!

I latë rrogat e pedagogëve për ibret e nuk i rritët, përvese vitin e fundit..

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I kthyet gati në kioska universitetet...

Albana Vokshi – Por i dhamë mundësi çdo studenti, çdo të riu të...

Thuaj të vërteta, jo të pavërteta! Fol për ligjin e arsimit të lartë...

Ismet Beqiraj – Ja, kjo është e vërteta, Albana, të lutem!

Unë kam qenë njëri nga kolegët që kam marrë pjesë fort kur është diskutuar projektligji për arsimin e lartë, ama nuk më vjen mirë dhe as nuk ndjehesha mirë kur bota akademike nuk përfshihej tërësisht në kushtetutën e vet, ta diskutonte. Bravo studentëve që na dhanë të gjithëve një mësim të mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, profesor! Jam pjesë brenda jush dhe e njoh shumë mirë këtë! E njoh mirë! Nuk jam natyrë e heshtur që të bëj sehir!

Mesazhi im është: nuk duhet ta politizojmë këtë çështje, pavarësisht se kemi protestat e 16-ës, kemi protestat e 20-ës, protestat e 5-majit e kështu me radhë, ndaj s’kemi pse ta politizojmë.

Në refleksionet e mia gjatë kësaj periudhe kam parë që kjo protestë, që na dha një mësim këtë dhjetor...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Politika është përpjekur me maska dhe pa maska për të futur duart dhe për të nxjerrë kapital nga kjo protestë, por ama, mua nuk më vjen mirë dhe nuk ndjehem mirë edhe si pedagog kur kolegë, që nga rilindja janë helmuar, janë vrarë për të hapur shkollat dhe sot, në fillim të shekullit 21, hidhen zinxhirët nëpër shkolla e fakultete.

Albana Vokshi – Sot ju i mbyllët ato që hapën “rilindasit”!

Ismet Beqiraj – Shumë mirë për ata që ngujohen, për ata që zaptojnë mjediset në universitetet, është në lirinë dhe të drejtën e tyre siç diskutohet, po pse nuk keni diskutuar edhe për ata të tjerët që duan të bëjnë mësim? A nuk kanë edhe ata të drejtën dhe lirinë ta bëjnë këtë?

Albana Vokshi – Të vijmë!

Ismet Beqiraj – Pse nuk keni diskutuar një herë për pedagogen e Fakultetit të Shkencave që u intimidua dhe u hodh nga shkallët? Unë po vij nga studentët, mbrëmë kisha 90% të tyre në leksion pa i intimiduar, por me dëshirën e tyre, të cilët më kërkuan që politika të mos përzihet në hallet dhe problemet e tyre. Ndaj, për të hyrë në normalitet, ne kemi diskutuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Luan, andej nga je ti dhe jam unë, kështu jemi!

Albana Vokshi – Keni gjysmë ore! Nuk replikon dot me të gjithë, të lutem!

Ismet Beqiraj – Ktheje në normalitet, të lutem, zonja kryetare!

Ne kemi eksperiencë, që edhe kur kemi diskutuar për orë të tëra, kemi përpiluar listën e palëve që kanë interes për ta diskutuar, qoftë edhe me një pedagog. I vendosni në rendin e ditës dhe të gjithë le të bëjmë dëgjesa gjithë muajt shkurt dhe mars.

Mbështes edhe këtë, po diskutohet ligji, shumë mirë, ashtu siç u bë nga kolegët e LSI-së, çfarë problemesh kanë për këtë vendim, për këtë pikë të ligjit e për të gjitha gjërat. Le t'i hyjmë diskutimit pa asnjë problem.

Albana Vokshi – Do t'i dëgjojmë!

Nora e ka kërkuar fjalën që në fillim.

Nora Malaj – E kuptoj shumë mirë të gjithë këtë tension, ngarkesë, debat dhe diskutim për disa arsye: së pari, vetëm në këtë komision jemi gati 11 personalitete të nderuara, që vijmë nga fusha akademike ose nga fusha e mësimdhënies, që në një formë a në një tjetër, duam apo nuk duam, jemi pjesë e ndjeshme përtej politikës apo politikave që bëjmë.

Së dyti, për një fakt shumë të rëndësishëm: jemi para një kolapsi në sistemin universitar. Fakti që kemi greva, fakti që pedagogët intimidohen, fakti që situata është jofunksionale dhe fakti i fundit, që mblidhet një asamble me 50, me 100, me 200 dhe na bën një kërkesë publike, do të thotë se parlamenti shqiptar me përfaqësuesit e zgjedhur që merren me hartimin e ligjit, me monitorimin e tij dhe me mirëzbatueshmërinë, ka detyrën imediate që të dëgjojë grupet e interesit. Çështja është a do t'i vendosim sipas shkallës së hierarkisë apo sipas shkallës së kërkesës, se cilët e kanë më imediate çështjen?

Dua t'ju sjell në vëmendje një model të para 8 vjetëve: po ky komision shkoi dhe vizitoi Komisionin e Edukimit në Finlandë dhe aty vuri re që ai komision, ndryshe nga komisionet e tjera, kur vinte puna për kauzën e arsimit, nuk ndahej në parti apo bindje politike, por merrte vendime unanime në të mirën kombëtare. Sot mendoj se nuk po diskutojmë një problem se cili e ka fajin, por tashmë jemi përpara një problemi që kërkon zgjidhje imediate, jemi para një situatë ku askush nga ne nuk mund të thotë se ju votuat, por ne jemi kundër. Ky është momenti t'i japim një zgjidhje problemit, se në të kundërtën pastaj me të vërtetë do të na thonë se edhe ju jeni pjesë e problemit dhe nuk paskeni qenë pjesë e zgjidhjes.

Propozimi im është: të nderuara zonja kryetare dhe zonja nënkryetare, vendoseni si të doni, me shkallë hierarkie apo me shkallë kërkesë, vetëm ejani se nuk kemi kohë! Pedagogët po presin, janë të frikësuar, janë të trembur! Prindërit shqiptarë po presin, studentët po presin, shkolla është ndarë, ku gjysma bën mësim, gjysma tjetër nuk bën. Nuk po kuptohet ç'po bëhet dhe në atë

që në gjuhën shqipe quhet “çorovole”; ejani t’i japim zgjidhje, se jemi Komisioni për Edukimin dhe Median, në të kundërt, rrimë kot, debatojmë me njëri-tjetrin, të themi cili jam unë e cili je ti, dhe pastaj të vazhdojmë të ngremë dorën apo të ulim kartonin.

Ky ishte propozimi im.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Fjala për Romeo Gurakuqin.

Romeo Gurakuqi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Dje u përpoqa t’u tërheq vëmendjen kolegëve të nderuar për rëndesën e problemit të krizës në sistemin universitar shqiptar. Të paktën prej disa muajsh në universitet nuk zhvillohet mësim. Në çdo vend normal demokratik, një qeveri, e cila nuk arrin dot të zgjidhë në mënyrë thelbësore dhe tërësore problemin e krizës në sistemin universitar, do të duhet të kishte reaguar në formë tjetër, së paku, pas dy muajsh duhej të dorëhiqej për t’u hapur rrugën zgjidhjeve, e parë kjo në këndvështrimin se kriza në sistemin universitar, në fakt, është pjesë e një krize tërësore që ka përfshirë vendin, është një krizë politike konstitucionale, e sistemit juridik, e përfshirë edhe me krizat e korrupsionit masiv. Me sa shoh, në vend që Kryeministri i vendit të reagojë pozitivisht, bazuar në arsyen e shëndoshë dhe në të mirën publike, në fakt, ka gjetur mënyrën që edhe komisionin e nderuar ta udhëheqë nga atje lart, nga zyra e tij, përkundër metodikës së punës, që do të duhet të kishte ky komision i nderuar.

Ne jemi këtu në komision për të bërë dëgjesa; së dyti, në rastin konkret, për të përcaktuar metodën e korrigjimit, startin e punës se nga duhet të nisët ky korrigjim, a do të duhet të jetë një korrigjim tërësor apo pjesor, a do të duhet të nisë nga korrigjimi i këtij ligji apo nga një institucion përgatitor, i cili do të duhet të realizojë konceptimin e korrigjimit të ligjit.

Së treti, një gjë shumë e rëndësishme, me të cilën do të duhet të merreshim në këtë komision, do të ishte rruga e korrigjimit të sistemit.

Së katërti, a duhet të bëjmë një zgjidhje pjesore, do të bëjmë makijazhe, sikurse unë, për fat të keq, kam parë në disa prej propozimeve që kanë ardhur këtu, në këtë komision, për t’u shqyrtuar, javën që shkoi, të cilat, sipas këndvështrimit tim nuk e zgjidhin fare problemin.

Së pesti, kjo është një çështje krejtësisht profesionale. Nuk bëhet fjalë për një zgjidhje populiste, por është një zgjidhje krejtësisht teknike, të cilën, si rregull, do të duhet ta bëjnë një numër njerëzish, që janë të paktë në këtë vend, të cilët arrijnë të lexojnë atë çfarë ka ndodhur me

ligjin pararendës, ligjin aktual, aktet nënligjore të dy kuadrove ligjorë të krijuara dhe impaktin që ka pasur në shoqëri dhe në shoqërinë universitare në veçanti.

As nuk e kam konceptuar që Kryeministri i vendit, në vend që të merret me zgjidhjen e problemit, të merret me anateme dhe me goditje të profesorit, gjë që është tërësisht e papranueshme.

Po ashtu, unë nuk e konceptoj që zgjidhja të realizohet nga personazhe rastësore, të pafajshme, të përfshira në krye të punëve të sektorit arsimor nga një përpjekje për bojatisje dhe për të ndërtuar fasada që, në fakt, fshehin thelbin e problemit dhe të pushtetit. Sipas këndvështrimit tim, kemi ardhur në një moment kur kërkohet një garanci politike për të ndërtuar një rrugë të korrigjimit të afërt dhe perspektiv të kuadrit ligjor. Me këtë nënkuptoj zgjidhjen e krizës imediate dhe fillimin e menjëhershëm të punës, në mënyrë që deri nga fundi i korrikut, së paku, universitetet të kenë një akt të ri rregullator, që të eliminojë të gjitha zbrazëtitë që mungesa e akteve nënligjore, disa parashikime dhe disa ndërhyrje përkundër aktit fillestar të parimeve të reformës, që janë bërë edhe në këtë institucion, natën e fundit dhe shumë net përpara, të cilat kanë prishur gjithë sistemin ose mosdëgjesa e amendamenteve që PD-ja ka bërë në atë kohë, e ka çuar krizën në këtë pikë.

Unë mendoj që një garanci politike është shumë e rëndësishme. Garancia politike është, në fakt, për të zgjidhur jo vetëm krizën e sistemit universitar shqiptar, por krizën politike në përgjithësi dhe këtu jemi të gjithë njerëz të arsimit dhe të shkencës, dhe merremi vesh njëri me tjetrin, në kuptimin e arsytimit dhe të racionalitetit për të mirën publike, dhe është e nevojshme që nga kjo sallë të dalin edhe kërkesat për mosmarrjen më nëpër këmbë të popullit Shqiptar, mosmarrjen më nëpër këmbë të universiteteve dhe zgjidhjen në kohën e duhur të problemeve, të cilat janë mahisur.

Studentët dhe profesorati që dëshiron një universitet ndryshe, nuk besoj se kanë për të pranuar një farsë të radhës, e cila do t'i lërë problemet aty ku ishin, në vorbullën e rrethuar me mediokritet, tarafe, pushtet force e komanduesve të derisotëm, të shkollave të larta, pro edhe të politikës.

Është koha, në fakt, për një ndërhyrje thelbësore, tërësore, të cilën mund ta bëjnë vetëm disa individë në këtë vend, me karakteristika të posaçme dhe mundësi intelektuale dhe profesionale të leximit të rrëmujës institucionale, ku është futur vendi për shkak të mediokritetit dhe të shmangies nga arsyeja e shëndoshë të kësaj qeverije, të cilën, për fat të keq, shqiptarët po e durojnë në shpinë të tyre.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Ulqini!

Musa Ulqini – Faleminderit, zonja kryetare!

Për hir të së vërtetës, unë bie dakord dhe e mirëkuptoj 100% diskursin e opozitës sot, këtu. Është e drejta e saj, se përfaqëson një segment të shoqërisë dhe problemet, dhe shqetësimet e asaj pjesë që ajo përfaqëson, dhe sipas mënyrës se si e mendon i sjell këtu në komision.

E vetmja gjë që nuk kuptoj dot është se çfarë lidhjeje ka diskutimi që bëjmë ne këtu, disa ndryshime për ligjin e arsimit të lartë, me protestën e studentëve.

Protesta e studentëve ishte një gjë tjetër. Unë dy herë kam parë njerëz të dalin në mënyrë të paorganizuar dhe në përmasa shumë të mëdha, i kam parë me sytë e mi, se kam qenë aty kur ka ndodhur: një herë kur njerëzit u ngritën për të rrëzuar sistemin dhe hera e dytë ka qenë për firmat piramidale. Me mijëra njerëz, në mënyrë të paorganizuar mbushën sheshet. Po shkoja në Belsh, në zonën time elektorale, dhe ndala makinën, kur pash një numër shumë të madh njerëzish, studentësh, të cilët po zbrisnin nga Qyteti Studenti.

Këta studentë të shumtë në numër protestuan dhe, në fakt, i bënë një *blackout* politikës, edhe neve, edhe juve. Pse? Sepse problemet për të cilat ata dolën, ato 8 pikat e famshme, nuk ishin krijuar as në një vit, as në 5 vjet dhe as në 8 vjet, dhe bënë shumë mirë që dolën. Nuk e pranuan qeverinë, sepse qeveria duhej t'i zgjidhte dhe ishte shumë logjike. Nuk e pranuan opozitën, që është rast i paprecedent, sepse opozita kishte dhe po provon që ka axhendë tjetër politike nga ajo çfarë kërkuan studentët.

Në asnjë nga 8 pikat e studentëve nuk flitej për ligjin e arsimit të lartë. Çfarë ndodhi? Qeveria si asnjëherë më parë reagoi, duke mos iu kundërvënë studentëve, por duke kërkuar që në një kohë sa më të shpejtë t'i njohë dhe t'i plotësojë kërkesat e tyre. Nuk ka ndodhur në Shqipëri deri më sot, që një qeveri që është në pushtet të jetë solidare me një protestë të madhe, siç ishte protesta e studentëve.

Kjo gjë prodhoi edhe një dokument, që është platforma dhe, si mendoni, ju që ne këtu e mbështesin platformën se kemi frikë?! Jo, ne nuk e mbështesim se kemi frikë. Ne jemi pjesë e një maxhorance, një pjesë janë në qeveri, një pjesë janë në parlament, jemi një maxhorancë që kemi përgjegjësi, që jemi votuar *en block* dhe mendojmë që kjo platformë është më e mira rrugë në situatën e sotme për të zgjidhur problemet e studentëve. Kjo nuk ka lidhje me frikën, por me

përgjegjshmërinë tonë politike, ka lidhje me votën që na ka sjellë këtu. Ju keni një axhendë tjetër, ju nuk keni në axhendën tuaj problemet e studentëve, ju keni ligjin e arsimit të lartë dhe jeni në të drejtën tuaj. E keni kundërshtuar në këtë komision me shumë forcë, kemi bërë një debat shumë të ndezur, është e drejta juaj.

Ne e miratuam alternativën tonë me të mirat dhe me të metat. Shkuam te shqiptarët edhe me atë ligj. Na votuan në 2017-n, ja ku jemi këtu. Ju keni të drejtë të jeni kundër ligjit të arsimit të lartë; ju keni të drejtë të mbështesni ata që janë kundër ligjit të arsimit të lartë, janë studentë, janë pedagogë, janë punonjës të medieeve, janë shqiptar të thjeshtë. Është një gjë normale. Jemi në një shoqëri demokratike. Ju jeni në rregull, po bëni punën tuaj. Ne jemi në të drejtën tonë. Qeveria është angazhuar maksimalisht dhe ne e kemi për detyrë ta mbështesim fuqimisht në këtë komision që atë platformë, që ka në thelb jo vetëm ato 8 kërkesa, por edhe më shumë se aq, t'i zgjidhim deri në fund.

Kështu që duhet të jemi shumë të qartë, se nuk po diskutojmë këtu për thelbin e një procedure parlamentare, por po diskutojmë për një gjë që është shumë më tepër se kaq. Ju keni axhendën tuaj, që është ligji i arsimit të lartë, ne kemi një axhendë tjetër, që është platforma për universitetin ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Krimin dhe drogën keni axhendë ju. Kjo është axhenda juaj. Jua tha Zëri i Amerikës fare qartë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Musa Ulqini – Unë sinqerisht jam i çuditur me mirësjelljen tuaj në këtë komision. A e dini pse? Se me thënë të drejtën, zonja Albana, ajo që ju kanë bërë studentët ju, është një gjë e paprecedent...

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Musa, jeni krejt të çoroditur. Ç'punë kanë studentët me ne? Ata dalin kundër qeverisë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Musa Ulqini – Ju garantoj se as nuk i mbushni sheshet më 16 shkurt, me ligjin e arsimit të lartë dhe as nuk i fitoni zgjedhjet. Prisni, kur të vijnë zgjedhjet, paraqisni ligjin e ri të arsimit të lartë dhe ecim përpara... Nuk kemi frikë nga asgjë. Axhenda juaj politike është e respektuar. Unë

ju mirëkuptoj, edhe kur flisni me zë të lartë, edhe me zë të ulët, edhe kur thoni gjëra që duhet, edhe kur thoni gjëra që nuk duhet...

Albana Vokshi – Zëri i Amerikës ka folur edhe për të rinjtë, edhe ato që ikin. Ka folur edhe për arsimin e lartë, foli edhe për krimin. Kjo është axhenda. E bënë dallimin qartë. Foli Amerika, ju duhet të heshtni, madje duhet të kishit ikur deri tani.

(Diskutime pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Nuk doja të analizoja të gjitha gjërat që u thanë këtu, por kjo e fundit e Musait më bëri përshtypje për atë se ç'na paskan punuar ne studentët. E di si është kjo, Musa? Si ai që lan fytyrën me ujë kanali dhe kur del para pasqyrës i duket vetja shumë i pastër. Ai, ujë kanali është për ju, sepse është ligji, janë ato problemet. Unë, në fakt, por prisja që ti, si kalorës i procedurës, i Rregullores, të flisje për zgjidhjen e procedurës, se për atë po flasim sot, jo për të bërë retorikë politike me emocione shumë të thella dhe për të na etiketuar ne si njerëz që kemi axhenda të segmenteve të caktuara. Jo, zoti Ulqini, më vjen keq që po të drejtohem, ne kemi axhenda të grupeve të interesit që përfaqësojnë interesat e gjithë shoqërisë shqiptare. Grupet kryesore të interesit sot janë dy shtyllat e universitetit publik, që janë studentët dhe pedagogët. Kjo është axhenda jonë. Në qoftë se ju i konsideroni studentët e Shqipërisë dhe studentët e zonës suaj elektorale segmente, ky është këndvështrimi juaj, është faji juaj. Ne kemi gjithë vullnetin dhe dëshirën për të parashtruar kërkesat e tyre, për t'i trajtuar kërkesat e tyre, për të gjetur zgjidhje, duke kërkuar edhe bashkëpunimin tuaj.

Ndërkohë, dua të bëj një vërejtje për pjesën e maxhorancës, se e kam dëgjuar shpesh, teksa i drejtohet LSI-së, ju e keni votuar ligjin e arsimit të lartë; nuk jam avokati i LSI-së dhe nuk keni të drejtë të flisni. Kjo është absurde, sepse në retorikë thoni vetë se një ligj duhet të kalojë disa vjet që të japë efekt. Ja pra, janë ngritur kundër efekteve dhe aq më tepër, meqenëse bashkë me Kejdin kemi qenë në një debat të gjerë për ligjin e arsimit të lartë, ata kanë kundërshtuar pjesë të ligjit, madje kemi qenë edhe në momentin e votimit, që deri në minutën e fundit nuk ishte vendosur, sepse ishin kërkesat e tyre që ju të reflektonit në VKM-të e sukseseve, që do të dilnin nga ligji i arsimit të lartë, gjë që ju nuk e bëtë në këto vjet. I keni sjellë vetëm para disa muajve VKM-të jo të plota dhe reagimi i tyre ka qenë i drejtë, në bazë të qëndrimit të tyre. Për më tepër, mos harroni se është një përfaqësues i LSI-së aty, profesor Rrokaj, i cili ka qenë ulur aty ku është Bujari, që s'duhet të rrijë aty, në fakt, dhe ka qenë një ndër kundërshtuesit kryesorë të ligjit të arsimit të lartë, si përfaqësi e rektoratit dhe e dekanatit me argumente.

Ismeti e tha gabim, bota akademike e ka shprehur kundërshtinë e saj të plotë. Kanë qenë 2000 faqe material të ardhura nga universitetet publike, që ne i kemi diskutuar këtu dhe kjo është e vërteta. Megjithatë, dashje pa dashje, sigurisht që kapemi nga retorika dhe unë u futa në problemet përtej procedurës.

Ne sot kemi një qëndrim të komisionit, që nuk pranon të vijë në dëgjese përfaqësia e asamblesë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Këtë po diskutojmë, që ata të vijnë në bazë të kërkesës së tyre dhe ne të hapim dyert e komisionit dhe të mos shqyejmë portat e universiteteve. Po hap një parantezë këtu, në qoftë se në 2013-n, sipas asaj formulës sonë, në Histori regjistroheshin 90 studentë, sot, sipas formulës suaj, regjistrohen 180. Keni shqyer edhe dritaret e fakulteteve.

(Diskutime pa mikrofon.)

Sot kemi edhe një qëndrim të Ministrisë së Arsimit, e cila është ekzekutivi juaj, është përfaqësia juaj. Ajo ka pranuar dhe ka njohur një grup të asamblesë, pasi ka hyrë në bisedime me ta. Ju e dini mirë cilët janë ata dhe u ligjërua...

(Diskutime pa mikrofon.)

Studentët në 8 pikat e tyre nuk kanë kërkuar gjë tjetër veçse abrogimin e ligjit të arsimit të lartë, sepse çështja e tarifave, çështja e rolit të studentëve, çështja e kartës së studentit janë çështje ligjore të ligjit të arsimit të lartë dhe nuk janë çështje të VKM-ve. Ne jemi ligjvënës dhe e dimë shumë mirë. Pra, ata në të gjitha pikat e parashtruara kërkuan abrogimin e ligjit të arsimit të lartë, por, meqenëse ju e donit ta kishin në formë eksplicite, në fund jua shtruan në formë eksplicite.

Edhe studentët, edhe pedagogët këtë problem kanë, sepse ai ligj ka dështuar hapësirën publike të universiteteve publike, ka dështuar hapësirën akademike të pedagogëve në universitetet publike dhe ata kanë probleme po aq akute, sikurse studentët.

Gjithçka është bërë gati dhe unë pa u futur tek emrat, nuk jam dakord fare me propozimin e Milvës, që ne grupet politike të përcaktojmë emra politikë. Pedagogu nuk ka ngjyrë politike dhe përfaqësia e asambleve, që është ligjëruar nga ju, jo nga ne, është pritur nga ministria e Arsimit.

Unë them që pa bërë debate të tjera, hajde ta hedhim në votim...

(Diskutime pa mikrofon)

Fadil Nasufi - Në lidhje me debatin që vazhdojmë të bëjmë për procedurë dhe pastaj e kalojmë në përmbajtje, e lidh gjithmonë me ata çka përfaqësojmë ne këtu si deputetë, që shumica

janë nga bota akademike. Kemi këtu dy nëpunësit kryesorë të shtetit, nënat dhe mësuesit, zonja të nderuara dhe profesorë të nderuar, por edhe midis tyre unë bëj një diferencë. Bëj diferencën e fjalamanëve, zhurmuesve, bëj diferencën e njerëzve që sado që janë përfaqësues politikë, dinë të ndajnë veten nga politika dhe të jenë të përkushtuar te çështja e arsimit dhe e botës akademike, por ka edhe personazhe që vërtet na impresionojnë dhe bëhen frymëzues, dhe bëhen të dhimbshur për çështje të ndryshme.

Për mua, për shembull, profesor Rrokaj është më me këmbë në tokë, më me pak emocion dhe pasion për këto probleme që ne diskutojmë.

Për të hyrë në procedurë ne duhet të bëjmë një kalendar të plotë të grupeve të interesit. Duhet të kuptojmë se kur është miratuar ligji i arsimit të lartë, u bë një reformë shumë e thellë dhe për thellësinë që pati reforma, që mbylli gjithë ato universitete private, që mbylli ciklin e diplomave e të librave që qarkullonin, të mos i futemi debatit, atëherë duket të kishte pasur protesta. Kjo shoqëria jonë e universiteteve është shumë me reminishencat e sistemit të kaluar, nuk është mësuar me autonomi, nuk është mësuar t'i nxjerrë paratë vetë, nuk është mësuar të menaxhojë vetë dhe këtë lloj sindrome do kohë ta shpëlajë, dhe reforma është shumë e thellë, edhe konceptuale, edhe reflektuese, se kërkon ndryshime në ligj, në të tëra ligjet. Fjala vjen, kërkon ndryshime të ligjit të shoqërive tregtare, që menaxhon konviktet, sepse gati 80% e fondeve atje shkojnë për ca rrogëtarë dhe nuk shkojnë për rehabilitimin e godinave; kërkon ndryshime në rregulloret dhe statutin e senatave apo të gjithë dokumenteve të shkruara dhe për këtë çështje ne duhet të na vijmë nga grupet e interesit propozime konkrete.

Në qoftë se juve, si opozitë, nuk ju pëlqen “pakti për universitetin”, është e drejta juaj, por ama ka ca propozime dhe zgjidhje se çfarë do të ndodhë me tarifat, çfarë do të ndodhë me çështjen e përfaqësimit të studentëve në senate, çfarë do të ndodhë me investimet në konvikte, çfarë do të ndodhë me çështjet e tjera. Ka edhe disa ndërhyrje lidhur me kohën e duhur, se kur do të bëhen. Kështu, këtu duhet të vijmë grupet e interesit, me propozime konkrete dhe me dokumente të shkruara, në mënyrë që ne këtu t'u bëjmë pyetje. Në qoftë se ata do të vijmë këtu për të dhënë konferenca shtypi dhe mesazhe politike, në fund të fundit, është e drejta e tyre, sepse ata që vijmë nga bota studentore dhe akademike, janë njerëzit më elitë të kësaj shoqërie. Neve na takon t'i dëgjojmë, por nuk do të harxhojmë kohë duke i pritur, sepse nuk është në dinjitetin tonë.

Unë jam dakord me propozimin e zotit Fidel, që ata duhet të vijmë këtu dhe të jenë edhe në ekstrem të gjykimit të tyre, por nuk është në performancën dhe në vizionin tonë, por edhe kohën

nuk e kemi të tepërt që t'i dëgjojmë pafund. Pra, ne duhet të dëgjojmë propozimet eficiente dhe, më pas, t'i kalojmë në filtrat përkatës të vendimmarrjes, për t'i kuruar këto probleme që kemi. Ne nuk themi se nuk ka probleme, sepse probleme ka sa të duash, por edhe kështu si i gjykojmë ne gjërat, bardh e zi, në emër të politikës, nuk mund të ndodhë!

Unë nuk jam këtu për të gjykuar njeri, sepse ne kemi folur gjithmonë për reformën e thellë, që është bërë në arsimin parauniversitar dhe në arsimin universitar, por, gjithsesi, hajdeni të thërrasim asamblenë e pedagogëve, dekanët, rektorët, ministren dhe grupet e studentëve dhe, më pas, të vazhdojmë me zgjidhjet dhe rekomandimet përkatëse. Nëse nuk ju pëlqen, janë institucionet përkatëse vendimmarrëse, që bëjnë mbështetjen e reformës apo kundërshtimin e reformës nga opozita, sepse, në fund të fundit, ky është mekanizmi i demokracisë që kemi.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po, zonja Adelina.

Adelina Rista – Faktikisht, zoti Fidel, sikur të ishte në mendjen time, e konsumoi shumicën e gjërave që doja të thosha, megjithatë unë do t'i them dy fjalë. Ju dje na servirët kalendarin dhe ramë dakord që do të vendoste kryesia, por sot jemi përsëri te pika e nisjes, te kalendarin. Kur nuk gjendet konsensusi midis palëve, midis kryetares dhe pjesës tjetër të anëtarëve të komisionit, kuptohet që ne kemi një numër të caktuar anëtarësh dhe instrumenti që vendos dakordësinë është vota. Kështu, do të hidhen propozimet dhe do të votohen. Ne këtë duhet të kishim bërë, por edhe pse jemi këtu për kalendarin, përsëri u përfshimë në debate që, faktikisht, nuk duhet t'i kishim bërë sot, sepse këto debate duhet t'i bënim, pasi të dëgjonim grupet e interesit. Në diskutimet e kalendarit ne nuk kishim pse të futeshim në hullinë e debateve të tilla.

Detyrimi dhe obligimi ynë është që të dëgjojmë të gjitha grupet e interesit, kur të diskutojmë një projektligj të caktuar. Detyrimi dhe obligimi ynë është që të dëgjojmë të gjitha grupet e interesit kur ata kanë nevojë për t'u dëgjuar, për të gjitha problematikat që hasin në jetën e përditshme nga implementimi i një ligji të caktuar. Detyra jonë si komision është që të listojmë të gjitha gupet e interesit dhe këtë duhet të kishim bërë që në fillim. Në kushtet kur nuk e gjetëm dakordësinë dje, sot, të gjithë bashkë, si komision, të bëjmë propozimet tona për grupet e interesit që do të thërrasim në dëgjuesë, t'i votojmë dhe sipas listimit që do të bëjmë, të fillojmë dëgjuesën.

Unë kam vetëm një kërkesë dhe i mëshoj fort: ne i ushtrojmë fort përgjegjësitë dhe detyrat tona si deputetë edhe në zonat ku jemi zgjedhur, sepse përfaqësojmë të gjithë atë elektorat, ndaj

fundjava duhet të na lihet e lirë. Kështu që hajdeni ta shfrytëzojmë ditën nga mëngjesi deri pasdite, në mënyrë që ditën e premte dhe ditën e shtunë të jemi në zonat tona dhe të ushtojmë përgjegjësitë tona si deputetë pranë zgjedhësve tanë, pranë atyre që na kanë besuar. Në qoftë se ne do të qëndrojmë në komision edhe ditën e premte, edhe të shtunën, si do t'i ushtrojmë përgjegjësitë tona në zonat tona elektorale? Prandaj, në atë kalendarin që ne do të miratojmë, duhet të punojmë pasdite edhe me seanca dëgjimore. Pra, le ta bëjmë pak më të ngjeshur dhe më të efektshëm kalendarin e punimeve, në mënyrë që ditën e premte të mos e zëmë me dëgjesa apo me mbledhje të komisionit.

Faleminderit!

Albana Vokshi- Faleminderit!

Zonja Adelina, unë mendoj se kjo kërkesë ka qenë gjithmonë në fokus, madje edhe ditët e hëna ne jemi përpjekur që, kur ju keni pasur ngarkesa, të mos i zëmë dhe të bashkojmë mbledhjet. Por, një herë në vit, unë nuk mendoj se një të premte paradite, që ju nuk shkoni në zonat tuaja, sepse mund të shkoni pasdite, nuk i kryeni funksionet tuaja si deputetë.

Unë mendoj se situata e agravuar lidhur me protestat e studentëve dhe grevën e pedagogëve ka përparësi. Pra, unë mendoj se një ditë në javë ju edhe mund të mos vini, kjo është në dëshirën tuaj, dhe nëse nuk bini dakord, ne do të bëjmë kërkesë dhe mund ta rregullojmë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne e kemi rregulluar këtë punë sa herë që keni bërë kërkesë.

Po, zonja Kejdi.

Kejdi Mehmetaj - E kam për procedurë shumë shkurt lidhur me ditën e premte. Komisioni ynë nuk ka ndonjë axhendë shumë të ngjeshur në përditshmërinë e tij, sepse në raste të caktuara ka javë që ne nuk bëjmë asnjë mbledhje komisioni dhe të diskutojmë tani një ditë të premte, më duket pak e tepërt.

Ne kemi fiks 1 orë e 49 minuta që diskutojmë nëse do t'i thërrasim apo nuk do t'i thërrasim grupet e interesit. Unë i dëgjova me vëmendje të gjithë kolegët, edhe të maxhorancës, dhe të gjithë thonë se duhet t'i thërrasim, sepse duhet t'i dëgjojmë të gjithë. Tani, edhe doni që t'i dëgjoni të gjithë, por nuk bini dakord për t'i thirrur dhe për të bërë listen! Pra, duhet ta sqarojmë këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, më lini të mbaroj!

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Dakord!

Të mbarojë Kejdi dhe përcaktojmë edhe procedurën.

Kejdi Mehmetaj – Lidhur me pjesën e ndarjes, unë e kuptoj se nga ana e deputetëve të maxhorancës ka keqkuptime, sepse kur shikojnë Kryeministrin që bën takime lart e poshtë me FRESH-in, u duket sikur edhe ne po thërrasim në komision FRESH-in apo forumet rimore. Ne po themi që të vijmë ata që duhet të vijmë, të cilët kanë kërkuar që t'i dëgjojmë. Mua më duket shumë abuzive që ju merrni përsipër të thoni këtu se ju kanë pritur apo nuk ju kanë pritur studentët, sepse ne kemi qenë çdo ditë me studentët, por nuk kemi nevojë që të bëjmë *show* si puna juaj apo si puna e Kryeministrit tuaj, që e nxjerrin përjashta nga aulat e universiteteve. Ne flasim, diskutojmë dhe marrim propozimet e tyre, dhe i sjellim këtu në Kuvend, sepse kjo është detyra jonë dhe kjo duhet të jetë edhe detyra juaj si deputetë. Mos thoni që keni axhenda të tjera, sepse axhenda e studentëve ka ndërruar më shumë se gjysmën e qeverisë. Të thoni se kjo është axhendë politike, më duket po aq abuzive sa kjo pjesa tjetër, që na kanë pranuar apo nuk na kanë pranuar. Në këtu midis nesh kemi edhe kolegë, të cilët ishin në qeveri, por nga protesta e studentëve sot janë deputetë të thjeshtë, një pjesë nuk janë, sepse nuk kanë qenë që në fillim, kështu që të mos abuzojmë. Unë e kuptoj që secili nga ne kërkon të gjejë argumentin e tij për ta mbrojtur, por juve ju ka rënë për hise të mbron këtë herë një gjë, që është shumë e vështirë për t'u mbrojtur, pothuajse e pamundur. I kuptoj qëndrimet tuaja, por, të paktën, minimumi që mund të bëni është t'i dëgjoni kur ata të vijmë këtu.

Unë jam e mendimit që këtu të vijmë përfaqësuesit e të gjitha grupeve të interesit që kanë kërkuar të vijmë.

(Diskutime pa mikrofon.)

LSI-ja refuzon që t'i ndajë profesorët në tanët dhe tuajit. Në qoftë se grupi i Partisë Socialiste ka merak dhe do të gjejë ndonjë, patjetër mund ta sjellë këtu dhe të bëjë çfarë të dojë, kurse ne refuzojmë t'i ndajmë profesorët me emra. Kështu që ne do të ftojmë instucionalisht ata që na kanë kërkuar t'i dëgjojmë, por edhe ata që na përcakton ligji se duhet t'i dëgjojmë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Më falni, a mund t'i ulim tonet dhe të mos bërtasim, sepse po diskutojmë?..

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kejdi kjo është e kuptueshme, sepse Edi Rama është shumë i shqetësuar nga studentët dhe pedagogët, prandaj është kjo situatë. A mendoni se sa e rëndë është situata kur pedagogët, elita e vendit, janë në grevë? Kryeministri nuk e përballon dot këtë situatë, prandaj nuk e pranon këtë gjendje. Kjo është kuptueshme, por ne duhet t'i dëgjojmë sipas radhës dhe sipas hierarkisë, qoftë një pedagog, qoftë 5 pedagogë, qoftë 5 studentë.

Milva Ekonomi – Këtu është më shumë se një grup.

Albana Vokshi – Pa u shqetësuar, mjafton që t'i dëgjojmë të gjithë.

E mirëkuptoj gjendjen dhe situatën tuaj ...

Milva Ekonomi – Ne jemi shumë të qetë, sepse në universitete ka filluar mësimi. Ka nisur pakti për universitetin, ndaj jemi shumë të qetë. E vetmja gjë që kërkojmë është të kalojmë te procedura dhe ju thamë se procedura është sipas ligjit të arsimit të lartë dhe statutit.

(Diskutimi pa mikrofon.)

Adelina Rista – Zonja Albana, sinjerisht dua t'ju bëj thirrje të gjithëve kur është fjala për arsimin. Arsimi është një e mirë publike dhe kur ne flasim në këndvështrimin “ju” dhe “ne”, sinjerisht mua më rrëqethet mishi. Nuk ka “ju” dhe “ne” për arsimin. Pedagogët nuk janë as të kuq, as blu, por janë edhe tanët edhe tuajit.

Albana Vokshi – Pse keni frikë, atëherë?!

Adelina Rista – Ju lutem, më lini të mbaroj!

Ai pedagog i jep mësim edhe fëmijës tim, edhe fëmijës tënd, ndaj nuk mund të ketë “ju” dhe “ne” kur flitet për të ardhmen. Unë do t'ju lutesha që të mos flasim më me “ju” dhe “ne” kur është fjala për arsimin. Ne duhet të jemi të gjithë bashkë, për një qëllim të përbashkët.

Albana Vokshi – Shumë mirë dhe të falënderoj!

Adelina Rista – Asnjeri prej nesh këtu absolutisht nuk është kundër dëgjësave, por unë jam kundër gjithë këtij debati pa vlerë, që po bëhet sot këtu për *show* politik. Ky debat duhet të bëhet, pasi ne të dëgjojmë të gjitha grupet e interesit dhe jo kur bëhet kalendari.

Sot ne jemi mbledhur për kalendarin, ndaj, ju lutem, duhet të kalojmë te procedura normale. Në qoftë se ju, si kryesuese e këtij komisioni, nuk keni rënë në dakordësi, atëherë instrumenti që e përcakton dakordësinë në komision është vota. Propozimet për grupet e interesit mund t'i merrni, sepse kjo është detyra juaj, të bëni një listim dhe ne t'u kushtojmë të gjithë kohën e mundshme të gjitha grupeve të interesit për t'i dëgjuar, duke mos përjashtuar asnjë. Ne do t'i dëgjojmë të gjithë, ashtu siç i kemi dëgjuar në ligjin për arsimin e lartë. Këtu janë kolegët që kanë

qenë bashkë me mua kur është miratuar ligji i arsimit të lartë dhe u kemi kushtuar të gjithë kohën e mundshme të gjithë dëgjësave, kanë marrë pjesë të gjithë deputetët kolegë, qoftë të LSI-së, qoftë të PD-së në diskutime, pavarësisht se cili e votoi apo jo në fund, por ama në debate kanë qenë të gjithë dhe kohën e mundshme për dëgjesa e kanë pasur të gjithë. Prandaj, zonja kryetare, le të marrim propozimet dhe të përcaktojmë se cilat grupe interesi do të thërrasim, pa përjashtuar askënd, dhe kjo punë kërkon një listim, se këtu nuk është han pa porta. Pra, sipas një liste të caktuar, t'i thërrasim dhe t'i dëgjojmë. Faleminderit!

Albana Vokshi –Dakord! Po, zoti Bujar.

Bujar Çela – Faleminderit!

Unë si fizik jam i shkurtër, zoti Fidel, jo se nuk kam pasur se çfarë të ha, por kam dashur të jem i koncentruar!

Unë i dëgjova të gjitha shqetësimet e kolegëve dhe pajtohem me shqetësimin e studentëve dhe pedagogëve, por duhet t'i thërrasim pak memories. Arsimi ynë ka kaluar në disa faza: si ishte, si është dhe si do ta bëjmë. Ne, që në krye të herës, kur kemi hartuar ligjin e arsimit, kemi menduar se ky është një ligj reformator, është një reformë si reforma e energjisë, si reforma e ujit e të tjerë.

Albana Vokshi –Pikërisht!

(Diskutime pa mikrofon.)

Bujar Çela – Pra, si të gjitha reformat e tjera edhe reforma e arsimit kërkon kohën e saj. Ne e dimë shumë mirë se ky ligj, këto reforma kanë dhimbje të ndryshme, sepse varet se ku të kapin. Në kirurgji ndiqet një praktikë, do të më falni për shprehjen, por ata që na dëgjojnë do të më kuptojnë, para se të futesh në sallën e operacionit, pavarësisht sëmundjes, duhet të firmosen disa dokumente. Tani, ndodh që edhe kur bëhesh synet ka disa dokumente që duhen firmosur. Ju mund të thoni: çfarë është kjo? Duket e rëndë dhe pa vlerë, por është e domosdoshme, prandaj bëhet. Ndaj, edhe këtu duhet një bisturi dhe bisturitë krijojnë dhimbje. Shumica e studentëve e duan arsimin, shumica e pedagogëve e duan ligjin. Cilët nuk e duan? Nuk e duan ata që duan të ngrenë kioska, ata që nuk duan shkollë, por duan diploma. Prandaj, të mos hallakatemi, ju doni të plotësoni procedurën, të bëni thirrje për 16 shkurtin e famshëm, por po ju them: do të keni minimumin e mundshëm, ju janë djegur mikrofonat, ndaj të fillojmë dhe të mos harxhojmë më kohë.

Albana Vokshi – Qenkeni bërë edhe fallxhor?!

Faleminderit, sepse gjithë këtë debat për arsimin e lartë e mbyllët me një diskutim historik dhe me një fjalor si mos më keq. Nuk kemi çfarë të bëjmë, sepse kur këtë fjalor e përdor ai te godina përballë, çfarë të presim ne nga deputetët e tjerë!

Unë do të doja që pas të gjitha diskutimeve, pas disa propozimeve, të futemi në procedurë. Të paktën ne, deputetët e opozitës, që jemi këtu duam t'i përgjigjemi në mënyrë të menjëhershme ftesës së Asamblesë së Pedagogëve. Nëse ju keni merakun se kush do të vijë, si do të përzgjidhen, sa pedagogë do të jenë e të tjerë, atëherë le të marrim të njëjtën përfaqësi që priti edhe ministrja, në mënyrë që ne të mos futemi në emra konkretë. Ajo i ka njohur ata ligjërisht, kështu që edhe ne, pak a shumë, të njëjtën gjë do të bëjmë, sepse përfaqësia është ligjëruar tashmë. Meqenëse ata e kanë bërë ftesën publike, ne duam që t'i përgjigjemi ftesës së tyre publike. Le të vijë e njëjta përfaqësi. Meqenëse kanë kërkuar ta hapin debatin në komision dhe duan që t'i ftojme, t'u japim hapësira dhe ato gjëra që kanë folur me ministren për ligjin e arsimit të lartë, le t'i thonë edhe këtu. Nuk ka rëndësi fare nëse ata do të hapin debat për rishikim apo për abrogim, sepse ne duhet t'u japim mundësi për t'u dëgjuar. Kjo është kërkesa e deputetëve të opozitës, por kjo nuk do të thotë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është kërkesa jonë dhe është shumë konkrete. Cila është konkretisht kërkesa juaj, zonja Milva, në mënyrë që ne ta diskutojmë këtu? Pra, hajdeni të flasim për kërkesa konkrete dhe t'i vendosim bashkë të dyja kërkesat tona. Shyqyr Zotit nuk do ta lemë te vota, sepse ndryshe nuk do të kishte mekanizëm kontrolli apo nuk do t'i jepej fare hapësirë opozitës. Ne do t'i rendisim të gjitha kërkesat dhe do të dëgjojmë të gjitha grupimet, të gjitha shoqatat, të gjithë qytetarët. Kështu që na thoni kërkesën tuaj konkrete.

Milva Ekonomi – Mua më vjen mirë që harxhuam aq kohë sa tha Nora për këtë mbledhje, sepse kuptuam një gjë të rëndësishme: është mirë që të kemi disa grupe interesi, që duam t'i dëgjojmë këtu dhe jo vetëm një grup interesi. Ajo që unë dua të propozoj, në emër të grupit të maxhorancës, është që dëgjesa e parë të bëhet me përfaqësuesit e Asamblesë së Profesorëve, të cilët do të vijnë këtu me anë të një kërkesë zyrtare, që do t'i bëjmë ne asamblesë. Më pas, ne mund të vazhdojmë me grupet e interesit, me studentët, me dekanët dhe rektorët, por dëgjesën e parë ne duhet ta bëjmë me përfaqësinë e ...

Albana Vokshi – Milva, kush e përcakton radhën këtu?

Milva Ekonomi – A më the të bëj kërkesën që e kemi formuluar?

Albana Vokshi – Unë thashë të bëni kërkesën, jo të përcaktoni radhën.

Milva Ekonomi – Kërkesën tonë e kemi bërë që dje me një grup përfaqësuesish të asamblesë.

Albana Vokshi – Caktoni ditën, kur e doni?

Milva Ekonomi – Nesër e duam.

Albana Vokshi – Në çfarë ore e doni?

Milva Ekonomi – Në orën 09:00, sepse në orën 10:00 dhe në orën 12:00 kemi dëgjuesë me ministrin.

Albana Vokshi – A biem dakord?

(Diskutime pa mikrofon.)

Duhet t'i ftojme të gjithë, edhe rektoratet, edhe dekanatet, edhe asambletë.

Milva Ekonomi – Ne dje ramë dakord...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne dje nuk ramë dakord, sepse thamë: “Nesër do të thërrasim në dëgjuesë asambletë e Universitetit të Tiranës”. Tani, të gjithë rektorët nuk janë të Universitetit të Tiranës, janë më shumë. Pra, në qoftë se do të miratojmë këtë kërkesë, duhet ta shënojmë në kalendar, sepse na bëhen shumë njerëz përnjëherësh. Kjo është e rëndësishme. Pra, do të thërrasim përfaqësuesit e asambleve sipas asaj që...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, të 6 fakulteteve që ka Universiteti i Tiranës.

Albana Vokshi – Po rektoratet përse i lini?

Milva Ekonomi – Nuk po i lë, sepse atje ka një rektorat, ka edhe pesë universitete të tjera.

Albana Vokshi – E saktë. Të vijnë të gjithë që të flasin.

Milva Ekonomi – Po, për të gjithë do të bëjmë kalendar dhe do t'u caktojmë të gjithëve orarin.

(Debat pa mikrofon.)

Kjo është e rëndësishme.

Shezai Rrokaj – Nëse do të mblidhen përfaqësues të asambleve, ata duhet të kenë mandat delegimi nga asambletë, 50% plus 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, se ka një rregull, nuk mund t'i sjellim pa mandat

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, Fidel, të bëj një sqarim.

(Debat pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Aq sa janë, ju pëlqen apo jo.

(Debat pa mikrofon.)

Doni të kaloni ju, por ne nuk duam.

(Debat pa mikrofon.)

Neve na kanë bërë ftesë publike, janë grup interesi dhe do të dëgjohen.

Shezai Rrokaj – As me ligj dhe as me statut nuk ka asamble të institucionit, por ka asamble të njësive bazë. Pra, nëse do të ftojme përfaqësues të asambleve të njësive bazë të universiteteve përkatëse, që janë të fakulteteve, kjo do të thotë që këto asamble duhet të delegojnë pranë komisionit me shumicën 50 plus 1, që të njihet statusi i tyre, sepse ai është statusi vendimmarrës. E para.

(Debat pa mikrofon.)

E dyta, asambleja, që ne themi në rang universiteti, është një bashkim vullnetar i asambleve apo përfaqësuesve të tyre, për t'u dhënë zë më shumë problematikave të tyre. Kjo është e drejta e tyre. Unë them që ky grup interesi, që ka shfaqur shqetësimin dhe që përbën edhe 30%, ta marrim të mirëqenë shifrën tuaj, duhet të vijë dhe duhet të fillojmë me këtë grup. Përse?

(Debat pa mikrofon.)

Për t'i respektuar, sepse ata kanë kërkuar të parët.

(Debat pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nesër në orën 9:00 do të vijmë asambletë, rektoratet dhe dekanët. Milva a jemi dakord?

Milva Ekonomi – Po, jemi dakord. Por më mirë ta lëmë në orën 10:00.

Albana Vokshi – Dakord në orën 10:00.

A jeni dakord të gjithë?

(Debat pa mikrofon.)

120 minuta do t'i ndajmë me aq grupe sa janë. Pra, do të thërrasim rektorët, dekanët dhe asambletë.

(Debat pa mikrofon.)

Si të doni!

(Debat pa mikrofon.)

Kur ta zgjedhin vetë. Të mblidhen asamblëtë, të zgjedhin përfaqësuesit dhe t'i sjellin.

(Debat pa mikrofon.)

A jemi dakord?

(Debat pa mikrofon.)

A jeni dakord të dëgjojmë grupin që na ka çuar ftesë publike të premten në orën 10:00?

(Debat pa mikrofon.)

Milva, a jeni dakord për të premten në orën 10:00?

Kejdi Mehmetaj– A mund të ftojme të premten edhe studentët, meqenëse mblidhemi?

Albana Vokshi – A jeni dakord të ftojme edhe studentët në orën 12:00?

(Debat pa mikrofon.)

Edhe një herë për të konkluduar, nesër në orën 10:00 do të thërrasim rektorët, dekanët dhe asamblëtë me përfaqësues të ligjëruar të UT-së.

(Debat pa mikrofon.)

Ftesa do t'u shkojë të gjithëve

Milva Ekonomi – Albana, ta përsërisim edhe një herë, në orën 10:00 kemi mbledhje me asamblëtë e Universitetit të Tiranës. A jemi dakord të bëhet?

(Debat pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ta bëjnë mbledhjen kur të duan, ky është problemi i tyre.

(Debat pa mikrofon.)

Nesër në orën 10:00 kemi mbledhje me asamblëtë e Universitetit të Tiranës.

Luçiano Boçi – Të lutem, se duhet të rregullojmë pak gjuhën, nuk ka asamble të Universitetit të Tiranës, por janë të fakulteteve, këtë e ke në ligj dhe në statut, prandaj nuk mund të themi “të universiteteve”.

Meqenëse të premten kemi lënë asamblëtë, sepse përfaqësia që na ka dërguar kërkesën është asamble, them që nesër të nisim me rektorët e universiteteve. Pra, të premten vijojmë me asamblëtë, sepse duhet delegimi që thotë profesori, pra ata kanë përcaktimet e veta dhe të sjellin kë të duan, e nuk kemi përse të ndërhyjmë.

Albana Vokshi – Ata kanë kërkuar nesër në orën 10:00.

(Debat pa mikrofon.)

Nesër thërrasim rektorët, dekanët, provojmë edhe me asamblëtë.

Milva Ekonomi – Problemi është të biem dakord edhe për një orar, me kryesinë, së bashku me Kejdin. Por edhe dje, kur e vendosëm këtë gjë, përsëri nuk konkludua, prandaj duhet ta hedhim në votim.

Albana Vokshi – Ne po biem dakord.

(Debat pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Hoqëm dorë nga emrat dhe bëmë të njëjtën kërkesë që po bëjmë tani. Pra, hoqëm dorë nga emrat dhe nuk ramë dakord.

Albana Vokshi – Milva, çfarë nuk të pëlqen te kjo kërkesë?

Milva Ekonomi – Nuk më pëlqejnë të gjitha, sepse dje thamë do të bëjmë më shumë se një dëgjese dhe sot ramë dakord që të bëjmë më shumë se një. Tani të biem dakord për radhën që do të zgjedhim dhe kë do të thërrasim, sepse kjo është e rëndësishme.

Albana Vokshi – Rektorët, dekanët dhe asamblëtë.

(Debat pa mikrofon.)

Si e doni, pra?

Milva Ekonomi – Radhën do ta bëjmë si të duam ne, dakord.

Albana Vokshi – Jo, radhën do ta bëjmë sipas hierarkisë. Në fillim të vijnë rektorët dhe pastaj asamblëtë, pastaj të vijnë si të duan ose bashkë, ose veç e veç. Caktojeni vetë.

Milva Ekonomi – Rektorët e Tiranës apo të të gjitha universiteteve?

(Debat pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Faleminderit, Luan!

(Debat pa mikrofon.)

Si fillim do të merremi vetëm me Universitetin e Tiranës, apo t'i thërrasim rektorët në shkallë vendi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, rektorët në orën 9:00 dhe asamblëtë në orën 10:00.

(Debat pa mikrofon.)

Doni t'i thërrisni bashkë?

(Debat pa mikrofon.)

Dakord në orën 10:00.

(Debat pa mikrofon.)

Nuk do të bëni asambljetë nesër?

(Debat pa mikrofon.)

Tani, më fal, ky ishte propozimi juaj. Ju e doni të parin?

Nëse doni nesër, ne jemi të gatshëm dhe mos thoni që po ju pengojmë.

(Debat pa mikrofon.)

Na thoni çfarë doni?

(Debat pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj – Nëse po e kuptoj qartë, nesër do të thërrasim rektoratin. Por kur thoni asambljetë, thoni ato grupe që janë mbledhur, apo kërkon diçka tjetër?

(Debat pa mikrofon.)

Atëherë i mbyllim të tria të premten.

(Debat pa mikrofon.)

Mirela Kumbaro – A mund ta bëjmë dëgjuesën të premten në orën 9:00 dhe të biem dakord për një përdorim efikas të kohës, që t’u jepet mundësia deputetëve të zonave të largëta të mbarojnë më herët?

(Debat pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Kur të doni.

(Debat pa mikrofon.)

Ne jemi gati të fillojmë me asambljetë që nesër, nëse doni.

(Debat pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj – Këta që janë mbledhur, janë mbledhur si rrjedhojë e asambleve të fakulteteve. Shkencat Sociale kanë dërguar përfaqësinë, Filologjiku ...

(Debat pa mikrofon.)

Lërimi tani, sepse ka procesverbale, të mos hyjmë në gjëra që i dimë të gjithë.

(Debat pa mikrofon.)

Nuk i keni të sakta, çfarë të të them unë, diskutoni për një tjetër.

Shkencat Sociale kanë mbledhur asamblenë, Filologjiku ka mbledhur asamblenë, drejtësia e ka mbledhur asamblenë, pra të gjithë i kanë mbledhur dhe i kanë çuar.

(Debat pa mikrofon.)

Dakord, se nuk ka rëndësi. Vali, janë të njëjtët dhe të vijë kush të dojë.

Milva Ekonomi – ... grupet e interesit merren si term, për arsye se na kanë kërkuar në mënyrë të hapur ligjore, kurse asamblenë e kërkojmë ne.

Valentina Duka – Edhe ata janë pjesë e asamblesë, prandaj të mos i ndajmë.

Milva Ekonomi – Sigurisht që janë pjesë e asambleve, por ata specifikisht ia kanë kërkuar komisionit. Që ne të mos i ndajmë, t'i thërrasim të dyja palët në mënyrë specifike dhe mbarojmë punë. Propozimi juaj qëndron dhe ejani ta votojmë.

Albana Vokshi – Do të kontaktojmë me rektorët dhe do t'ju kthejmë përgjigje për orarin. Në orën 12:00 është ministri Lleshaj.

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA